

Giuseppe Schirò Di Maggio

Shumë vizita  
Molte visite



Palermo 2009

Quaderni di BIBLOS

---

TEATRO 22/2

Kartularet e BIBLOS

TEATRI 22/2

ZEF SKIRO DI MAXHO

# SHUMË VIZITA

vepër origjinale në tri akte

Palermë 2009

*La pubblicazione, a cura della biblioteca comunale «G. Schirò» di Piana degli Albanesi, fa parte degli interventi attuativi ex L. 482/99 per l'es. 2006 ricompresi al progetto "Fabrika e fjalëvet 2006".*

2009 © *Unione dei Comuni*  
*Lidhja e Bashkivet*  
BESA

SCHIRÒ DI MAGGIO, Giuseppe

Molte visite: opera originale in tre atti / Giuseppe Schirò Di Maggio. – Palermo : BESA, 2009. – 128 p. ; 21 cm. – (Quaderni di Biblios ; 22/2. Teatro). –

1. ALBANESI D'ITALIA – Sicilia – Letteratura 2. SCHIRÒ DI MAGGIO GIUSEPPE – Opere teatrali

891.9912 Letteratura drammatica albanese CDD 20

*Scheda catalogafica a cura della biblioteca comunale "Giuseppe Schirò" di Piana degli Albanesi*



*Në i dëshpëruar  
për dashuri të vdisja,  
çë dobi do t'i kisha?  
Vetëm ngjersa rronj  
shoh gruan time.*

(Otomo Momoyo, shek. VIII pas K.)

## PERSONAZHE

VËRGOLLI	- i kopjasëm; ulur në karrocele
BARDHYLLI	- i vëllai, i paralinduri
URSULLA	- e motra, e dyta
LENA	- e jëma
VINAU	- i jati
AMELIA	- vajzë fantazmë
GJONI	- i jati fantazmë i Amelies
FINA	- e jëma fantazmë e Amelies
THODHA	- gjyshja fantazmë e Amelies
MIKU	- i Vërgollit
PAPA THANASI	- prifti arbëresh
GAUDENCJA	- nusja e Bardhyllit

## AKTI I

Skenari ë i njëjtë në të tri aktet: dhoma e ngrënies edhe e pritjes; te një angonë (kënd) një televizor gjithmonë i shuar. Kuçina (kuzhina) jashtë skenës.

## SKENA I

### LENA

LENA - (*Shtroen tryezën pa nxitim*) Kush e di si janë shërbiset (gjërat) te kjo jetë e... te jetra! Te kjo jetë gëzimi ë përzier me dhëmbjen! U pata tre bij: gëzimi i madh për një grua! Tre bij të tre të mirë; ma (por) te zëmbra kam një glëmp. Thonë se ëndrravet një ngë (nuk) ka t'i ketë besë! Më parë se të më lehej i pari, ëndërrijta se isha te strati çë flëja, kur një dritë sa hyn nga dritarja e më zgjon: ngrëhem dal'e dalë e vete vërenj nga vjen kjo dritë. E ndëlgoja (kuptoja) se isha n'ëndërr, ma (por) u ndihesha zgjuar! Façar (paraqitem në dritare) e shoh një... yll atje lart në qiell: ish i bardhë e bëj dritë më shumë se hënëza... Më leu (lindi) një djalë i bukur vërtet si yll! Tim shoqi i thashë se kish e thërrisjëm "Yll i bardhë", se ai dej (donte) t'e thërrisjëm "Dimitër" si të jatin! Pra si e pagëzuam, papa Thanasi, çë njih gjithë storjet (historitë) arbëreshe, më tha t'e thërrisjëm "Bardhyll", si një nip - thotse - i Kastriotit, Skënderbegu! (*Vazhdon të shtrojë, duke vënë në tryezë një talur më shumë se sa janë pjesëtarët e familjes*). E dyta kle (qe) vajzë, Ursulla, si nona (gjyshja); thomse (ndoshta) se

ish e dyta, ëndërrijta më pak - ng'e kujtonj çë ëndërrijta...Vajza ë e mirë e masare (nikoqire). Më parë se të blija të tretin - "sia fata la vuluntà di Diu"! (u bëftë vullimi i t'yn' Zoti!) - e di ai si ndihesha... ngë flëja natën: më zëjën suvalë e shihja - "sia fata!" - ... zunë të më bëjën vistë, të më diljën ca... - si ka e thom - ca... shpirtra! Burrë e grua; e bija e këtyre e nona e vajzës: një pruçisjonë! Hyjën e diljën sikurse ishën te shtëpia e tyre! Të parat herë trëmbesha; kisha rricaturë (mornica) e më zëj freva (ethe); ma pran pashë se ishën të butë: natën më bëjën kumpanji (shoqëri) e kur ngë mënd flëja, flisjëm. Ma (por) edhe ditën, kur im shoq vej përjashta (te dherat)... Ish e thëshja se kur prisja të tretin, vete ëndërrinj se isha t'ujur (ulur) te një shexhë (karrige) e bëja te bushtë: ish e i pripararja (përgatitja) shalinin (shallin) e bardhë të pagëzimit - isha n' ëndërr ma (por) flisja me ata shpirtra; më duket se burri ngë ish atë herë - kur si ish e bëja të sprasmen llojatë (radhë) të shalinit... më lehet djali! "Onipotencia di Diu"! (pushteti i t'yn' Zoti!), te shexha isha e te shexha qëndrova: 'lurita (ulurita) te ëndërra me sa ah kisha te mushkëritë e ata... shpirtrat, si panë ashtu, më dhanë ndihmë: më morën e më qellën te strati; ma (por) djali më qëndroi te shexha!

## SKENA II

### LENA, VËRGOLLI

- VËRGOLLI - *(Hyn nga dera e brëndshme ulur në karrige me rrotele. Me zë predikues t'jëmës:)* Mëkatët e prindravet bien te bijtë; ma (por) mëkata jote ra mbi mua: tek i sprasmi...
- LENA - I madh'yn Zot, mëkatë aqë të rënda kam bërë? *(Vazhdon të shtrojë tryezën.)*
- VËRGOLLI - Dëshirove të lehesha m'i bukur se Bardhylli: kjo ë mëkata jote, përçë (sepse) m'i bukur se Bardhylli ngë kish lehej më njeri!
- LENA - Gjithë bijtë janë të bukur! Ti e ke me tët vëlla... Ai të do mirë...
- VËRGOLLI - Dashuria ë bukuri: kush ë i bukur do mirë; kush ë i shëmtuam ka e shëmtuame edhe zëmrën.
- LENA - Kalloi, i biri i La' Binardit, ë aqë i shëmtuam se duket sikur e puthi djalli, ma (por) ë një dialë i butë.

- VËRGOLLI - Djalli e puthi jashta e ëngjëlli e puthi te zëmra. E mua kush më puthi?  
 LENA - Të putha u!  
 VËRGOLLI - Puthë mëkatën tënde: u jam mëkata jote!  
 LENA - U ngë kam bërë mëkatë aqë të rënda!  
 VËRGOLLI - I bëri jot'ëmë o e jëma e sat'ëmje ngjera tek e shtata gjini!

### SKENA III

#### ATA, BARDHYLLI

- BARDHYLLI - (*Vjen nga jashtë.*) Mo', kur ka hamë!  
 VËRGOLLI - Burri ë pratiku (praktik): kur ka hamë!  
 BARDHYLLI - Ti qetu e rri te angona jote!  
 LENA - (*Bardhyllit*) Nani çë je zë ti?  
 BARDHYLLI - Ai zuri!  
 LENA - (*Hyn e del nga kuzhina. Bardhyllit:*) Gjete shërbëtyrë (punë)?  
 BARDHYLLI - (*Ulet*) E ku kish e gjeja! Vajta te “u kolokamentu” (zyra e punës), ma (por) ish fulë...  
 LENA - Ish fulë e ti ngë prite! (*Vërgolli gjegjet-dëgjon me interes.*)  
 BARDHYLLI - Të priturit për mua ë shërbëtyrë e mosnjeri më paguan: “tantu vali” (më mirë) se...  
 VËRGOLLI - Rri te qaca (sheshi)!  
 BARDHYLLI - Mo', e gjegje (dëgjon)?  
 LENA - Ëj (po), ma ti mënd kishe pritur! Tyt eti çë ka i thuash se ish fulë te “u kolokamentu” (zyra e punës)?  
 BARDHYLLI - Në ngë më ka besë, vete pret ai...  
 LENA - “Sia fata!” Nga këta të folur ë? Ashtu të mësuam të flaç? O mjera u: një bir çë ngë do gjegjet për shërbëtyrë e...  
 VËRGOLLI - E një bir i kopjasëm! Shih se harrove tët bijë!  
 LENA - Ajo almenu (të paktën) e kërkon shërbëtyrën!  
 VËRGOLLI - Eh, sekretarje “d'azienda” (ndërmarrje), ku “azienda” vjen më thënë proprietar (pronar) e proprietari duart i ka të glata! (*Bën gjestin.*)  
 LENA - Vërgo', biri im, bëj të mirin!  
 BARDHYLLI - (*Lenës:*) Në ka hamë m'e thua, “mosinò” (ndryshe) vete pë “l'afari” timshit (për punët e mia)!  
 VËRGOLLI - “Ibis redibis”: pititin (oreksin) e ke!  
 BARDHYLLI - (*Me durim*) Nani zë me “lu grecu” (greqishten)!  
 VËRGOLLI - (*Ndizet e citon përmendsh në greqishte:*) “... ἄπορος



ἐπ'οὐδὲν ἔρχεται τὸ μέλλον· Ἄιδα μόνον φεῦξιν οὐκ ἐπάξετε· νόσων δ' ἀμιχάνων φυγὰς ξυμπέφρασται.”  
 (Sofokliu: Antigona - kënga e parë e korit) - Gjithë i sigurt përballon të ardhmen; nga Mortja vetëm ngë mënd të jikën; por gjeti vjershin të mundënj sëmundjet e rënda! - Sei bello! (Je i bukur!) (*I thotë të vëllait.*)

- BARDHYLLI - Më çë shumë flet më shumë i daljën fjalët...  
 VËRGOLLI - Sei bello!  
 LENA - (*E shqetësuar:*) Pameta isht e i vjen...  
 BARDHYLLI - Ngaditë më këtë herë... sikurse e bën aposta (apostafat).  
 LENA - (*Bardhyllit*) Ti qetu e mos i jip kordë.  
 BARDHYLLI - U i jap kordë? Ë ai çë e merr...  
 LENA - Vërgo', biri im, sose ca herë...  
 VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) Edhe te emri jam i kopjasëm: Vërgo'! Vërgoooo! (*Lenës:*) Në më kishë thërritur “Vërgonjë” (turp) më kish pëlqyer më shumë! “Nomina - Numina”! Emri ë fati! Ashtu si kam emrin, ashtu jam: Vërgo'! I mbjedhur, i kërrusur, i kopjasëm! (*Me ëmbëlsi, por me ca ironi:*) Im vëlla për-kundra thërritet “Bardhyll”: Yll i Bardhë, drita çë gëzohet se ë dritë!  
 BARDHYLLI - (*Bën të nisët*) Jam e vete!  
 LENA - Vërgo', qetu. Kush i ftes (ka faj) në nonit (gjyshit) i thë-shjën “Vërgoll”.  
 VËRGOLLI - Kush e vuri te jeta! E jëma e i jati i ftesjën! Emri jep fatin tënd: u si leva (linda), gjegja (dëgjova): “Vërgo'!” e u shtrëmb-ova gjithë si dredhë dhrije (hardhie)!

#### SKENA IV ATA, VINAU

- VINAU - (*Hyn; veshur si pronar dherash*) Çë kini!  
 LENA - E çë ka kemi: tët bij...  
 VINAU - U jam lodhët e ngë dua gjegjem (dëgjoj) gjë! Vër brumit!  
 LENA - Kudhi ziejti, ma (por) e shuajta: presjëm tët bijë nga Palerma.  
 VINAU - Ngë ka jardhur ankora (ende)? (*Ulet te vendi i tij në krye të tryzës.*)  
 LENA - Të vinjë ka! Tryeza ë shtruar: sa vjen jot bijë vë brumit te kudhi.

- VINAU - (*Bardhyllit*) Gjete shërbëtyrë?
- BARDHYLLI - Jo, ish fulë.
- VINAU - Ish fulë ku: te shërbëtyra?
- VËRGOLLI - Ah! Ah! Ah! Fulë te shërbëtyra: i dollën trutë gjithëve të vejën e kërkujën shërbëtyrë!
- BARDHYLLI - (*I shqetësuar*) Ish fulë e pra' ish e ngrisej.
- VINAU - Me një fjalë: ngë gjete shërbëtyrë.
- BARDHYLLI - Jo.
- VINAU - Kur e gjen, m'e thua!
- VËRGOLLI - Ih! Ih! Ih! Kur e gjen, ia thotë!
- BARDHYLLI - Ma ç'e e gjegje, ta'?
- VINAU - Kë?!
- BARDHYLLI - (*Dëfton të vëllain*) Qesh e më bën notat (imiton notat, tonin)...
- VINAU - Ai mënd bënj çë do; ma (por) ti ngë gjete shërbëtyrë.
- BARDHYLLI - E ç' i ftes u në ngë e gjeta: ku ë kjo shërbëtyrë?!
- LENA - Në ti pret se ka të vinjë te këmbët!
- VINAU - Të jap edhe këtë javë: në ngë e gjen vjen e shërben përjashta (te dherat).
- VËRGOLLI - "Un signorino" (djale zotërie) përjashta? "Vade retro" përjashta!
- VINAU - Rri mirë, Vërgo', se kujdesem u. (*Vëren tryezën e i thotë Lenës:*) E ti pameta e vure atë tajur (talur, pjatë) më shumë?
- LENA - Ë një devocjonë: një tajur më shumë pë' kë vjen pa pritur...
- VINAU - U ngë kam parë kurrë të vinjë ndonjeri pa pritur!
- VËRGOLLI - Mëma bën mirë: një tajur më shumë pë' kë vjen pa pritur o... i pritur!
- VINAU - Devocionët bëji pë' tët bir të gjenj shërbëtyrë; "mosinò" (ndryshe) e qell përjashta.
- LENA - Një kopil me këtë fugurë (këtë fytyrë) përjashta ë sbjerrë. Prit e sheh se e gjen shërbëtyrën....
- VINAU - Kam pritur!
- VËRGOLLI - Prit sot e prit nestrë (nesër) - ka i rritet bishti hardhjes!
- BARDHYLLI - (*I nxehur*) Foli!
- VINAU - (*Lenës*) Jot bijë mënon.
- LENA - Thomse posta (autobusi) pati guastu (dëm).
- VINAU - Vër brumit: kur vjen ia ngroh.

VËRGOLLI - Ah, ah, ah!  
BARDHYLLI - Përçë qesh?!  
VËRGOLLI - E di u!

*(Bëhet heshtje e thellë si ndodh në disa momente të jashtzakonshme. Vinau e Bardhylli rrinë në mendime, ndërsa Lena e Vërgolli janë të shqetësuar sikurse presin ndonjeri...)*

SKENA V  
ATA, GJONI

GJONI - *(Dalë e dalë e pa zhurmë, hyn nga dera e brëndshme, i veshur me petka të bardha, fytyrën e zbehtë; e shohin vetëm Lena e Vërgolli. Thotë me zë të hollë:)* Sonte më nget (përket) mua të rri te tryeza... Çë ngë ë hera?

LENA - *(Me një fill zëri Gjonit:)* Presjëm vajzën nga Palerma... *(Pastaj shkon në kuzhinë.)*

VËRGOLLI - *(Qaset me shexhën me rrotele te Gjoni, ndërsa i jati e i vëllai rrinë në mendime.)* E çë, ashtu hyhet? Mua ngë më fale?

GJONI - Të falem Vërgo! Sonte si ndihe?

VËRGOLLI - Eh, u ndihem si i kopjasëm! E zotrote?

GJONI - Mah, ashtu... sikurse jam e ngë jam...

LENA - *(Hyn e i thotë Gjonit:)* T'uju (ulu) te vendi yt. *(Tjerëve:)* Zëni fill e qasij se brumit isht e zihet.

GJONI - *(Ulet te vendi i tij.)* Haristis (falemnderit).

VËRGOLLI - *(Vendoset afër Gjonit e i thotë të vëllait:)* Bardhyll, ti ngë sheh atë çë shoh u!

BARDHYLLI - *(Me mërzi)* Pameta je zë? Ngaditë po më thotë "ti ngë sheh atë çë shoh u"! ma kujt ia rrëfien...

VINAU - *(Me mërzi)* Vërgo', rri ca herë pa folë: këtu mosnjeri sheh atë çë sheh ti!

VËRGOLLI - Jo, ngë ë flet (vërtet)! Edhe mëma sheh atë çë shoh u!

VINAU - *(Lenës, që hyn e del nga kuzhina:)* Ë flet?

LENA - Nga çë të shkon për krei, Vërgo'! Qetu e bëna të hamë në paqe.

VËRGOLLI - *(Të jatit e të vëllait)* Me kë flas u nani?

GJONI - *(Vërgollit)* Le të jesë, Vërgo': ata ngë më shohjën e ti i rrahxhar (mërzin) pa "mutivu" (arsye).

VËRGOLLI - Në e thua zotrote, qetem!

VINAU - E ndëlgove (kuptove)? Bravu: qetu!



- VËRGOLLI - (*Me vetë*) Me një fjalë kunditarta (kënaqa) dy vetë!  
(*Gjithëve:*) Nani flas vetëm...
- VINAU - Flit (fol) vetëm, ma dal' e dalë se ngë mënd gjegjem batari  
(rrëmujë, zhurmë)...
- VËRGOLLI - La' Gjoni, si rri jot bijë? (*Vinau e Bardhylli e vërejnë me  
mërzit*)
- GJONI - Eh, ngë rri lig; kish dishiruar të vij (vinte) ajo sonte, ma  
(por) jerdha u se ka i thom një fjalë sat'ëmje.
- BARDHYLLI - (*Lenës me zë të lartë:*) Mo', u zie?
- LENA - (*Nga kuzhina*) Jam e vë brumit te tajuri....
- VINAU - Jot bijë mënon...
- LENA - (*Nga kuzhina*) Të vinjë ka....(*Hyn me një superë plot me  
makarona me salcë, mbush talurin e të shoqit e andaj atë të  
Gjonit.*)
- VINAU - Pameta tajurin plot aty: kush ka t' e hanj!?
- VËRGOLLI - Në ka këtë devocjonë!
- VINAU - E brumit shtihet!
- LENA - (*Ndërsa mbush talurët e tjerë:*) Ngë shtihet, se në qëndron  
nestrë (nesër) e diganis e e ha u.
- VINAU - (*I mërijtur:*) Nani (tani) hamë... (*Lena ulet; gjithë hanë,  
përveç Gjonit.*)
- LENA - (*Gjonit:*) Ngë (nuk) je ha?
- VINAU - (*Së bashku:*) Ngë jam e ha?!
- BARDHYLLI - (*Së bashku:*) Ngë jam e ha?!
- LENA - Ngë jue thëshja juve...
- VËRGOLLI - M' e tha mua!
- VINAU - E ti ha!
- LENA - (*Me zë të ulët Gjonit:*) Përçë (pse) ngë ha?
- GJONI - Sontë ngë më vete..., ngë më kallar (zbret)... Ka të flas për  
time bijë...
- LENA - Si nani ha.
- GJONI - Ngë ë dre të vdes pa ngrënë!
- VËRGOLLI - Ah, ah, ah!!! (*Shpërthen nga gazi, ndërsa Vinau e Bardhylli  
e vërejnë të çuditur.*)
- GJONI - Vërgolli qesh...
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) Qesh se ti më bën të qesh!
- BARDHYLLI - Kush ë çë të bën të qesësh?!?
- VËRGOLLI - Ti jo! E di u kush më bën të qesh!
- BARDHYLLI - (*I mërijtur:*) Ma vëre' në ka hash!



SKENA VI  
ATA, URSULLA

- URSULLA - (*Hyn nga dera e jashtme si me vrap*) Kjo mallanat (e mallëkuar) postje! (autobusi)
- LENA - Mënove!
- URSULLA - Ngë i ftes u! (*Shkon në dhomën e saj për të lënë borsën.*)
- VËRGOLLI - Hypur i ka! Kush ja hypi?
- LENA - Në i ka hypur, mos i flini (flitni).
- VËRGOLLI - Në rrimë pa folë i hypen më shumë!
- VINAU - Hani e lenie kujetu (në paqe).
- URSULLA - (*Hyn e sheh dy vende të zbrazët*) Ku ë vendi im?!
- VËRGOLLI - Ngë e di ku ë vendi yt?
- URSULLA - Këtu janë dy tajurë: nga ditë kjo storje (mërzitje)! Çili ë imi? (*Bën të ulet në karrigen ku është Gjoni.*)
- VËRGOLLI - (*Me gaz:*) Jo, aty jo... aty jo!
- URSULLA - E përçë (pse) këtu jo?
- VINAU - Aty ë devocjona!
- URSULLA - Devocjonë o jo, u kam pitit (oreks), se ka një ditë çë shërbenj...
- VËRGOLLI - (*Bën një gaz të imtë:*) Ih, ih, ih! Aty jo! Se u e di se do t'ujesh (ulesh) aty, ma ngë mënd: ë "okupato" (zënë)!
- URSULLA - Pa hyjtur e xha (adha) më lënëson trutë!
- LENA - (*Duke dëftuar karrigen vërtet e zbrazët:*) T'uju (ulu) aty, se paraç (baras, njësoj) ë.
- VËRGOLLI - Ngë ë paraç: aty ë mbrazët e këtu ë "okupato" (zënë)!
- GJONI - Qetu Vërgo', lei në paqe...
- URSULLA - (*Ulet në karrigen e zbrazët*) Në mes të lënëvet (marrëvet) jam!
- VËRGOLLI - Ngë je në mes të lënëvet..., je në mes... Ti ngë di kë ke te ana!
- URSULLA - (*E mërijtur*) Kam tyj e më arrën. U shërbenj gjithë ditën, vete e vinj ka Palerma: kur hynj brënda te shtëpia dishiroja të prëhesha e "inveçi" (ndryshe, përkundra) ka gjegjem lënësitë e tim vëllai!
- LENA - Nga, ti ngë e di se ë kështu?
- URSULLA - E 'strote (zotrote) çë e difindir (mbron)! U jam lodhët e ngë kam dishirim t'i vete prapa lënësitë të tija! (*Kërkon të hajë.*)
- VINAU - Ha e prëju, në mënd...

- VËRGOLLI - (*Ursullës*) Përçë je lodhët?  
 URSULLA - (*Ndërsa ha:*) Përçë shërbenj!  
 VËRGOLLI - Me kë?! (*Ndërsa ha*)  
 URSULLA - (*Ia pyen tjerëve:*) Çë do thetë me kë?!  
 LENA - Qetu Vërgo', le kujetu (në paqe)!  
 (*Bëhet heshtje; ndërkaq hanë, përveç Gjonit.*)

SKENA VII  
 ATA, AMELIA

- AMELIA - (*Hyn nga dera e brëndshme, veshur me një linjë të bardhë; ecën ngadalë me shumë dyshime; bën dy hapa, qëndron, vëren Bardhyllin e i buzëqesh. Vërgolli është i vetmi që e sheh, veç tjemës e natyrisht Gjonit.*) Oh, je këtu! (*Thotë për Bardhyllin.*)  
 VËRGOLLI - (*Shtang dhe e vëren me gojë të hapur.*) Gjymisë grua e gjymisë ëndërr - si thotë poeti!!!  
 URSULLA - (*Me habi:*) E çë të zë nani!  
 VINAU - I zë atë ç'i ka zënë ngaherë... (*Vazhdon të hajë.*)  
 BARDHYLLI - Mah! (*Vazhdon të hajë.*)  
 LENA - Mos i jpnit kunt (mos i vini re). (*Ha.*)  
 AMELIA - (*Ecën ngadalë dhe afrohet te Bardhylli:*) Të natës sime ti je drita!  
 VËRGOLLI - (*Ulërin duke vërejtur në sy Amelien:*) U jam këtu!  
 URSULLA - Pameta! Ky o e bën aposta (apostafat) o ë i lënë!  
 LENA - Qetu e le të thetë çë do...  
 VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) "U" këtu jam! (*Të afërmit e mërijtur, bëjnë gjeste durimi.*)  
 AMELIA - (*Bardhyllit*) Kur jam ndanëz (afër) teje, ndihem e gjallë! (*Bën t'i përkëdhelë flokët, por nuk guxon.*)  
 GJONI - (*Me ëmbëlsi:*) Amelie, bija ime, ngë të thashë se sonte vija u këtu? I flas u për tyj. Ti më mirë të veç atej, se këtu sonte shërbesi ë trubull...  
 LENA - (*Me zë të lartë*) Kush ë trubull!?!  
 VINAU - (*Alarmuar:*) Kush ë trubull!  
 BARDHYLLI - (*Alarmuar:*) Kush ë trubull!  
 URSULLA - (*Alarmuar:*) Kush ë trubull!  
 LENA - Ngë flisja me ju...  
 URSULLA - E me kë flisje!?  
 LENA - Pincarja (mendoja) me zë' të lartë... Hani!

- URSULLA - Mo', në ka zësh vidhema (edhe) strote (zotrote) këtu bëhet spicji (çmendina) "kompletu"!
- VINAU - Lenë, mos pincar me zë' të lartë, bëjme "pi' piaçiri"... (për hir, qejf).
- GJONI - Amelie, jic te jot'ëmë... I flas u...
- AMELIA - (*Afër Bardhyllit, me ëmbëlsi të rrallë:*) Më batir (rrah) aqë fort gjiri se ndjenj sikurse kam zëmren... e je ti zëmra ime!
- VËRGOLLI - (*Vëren me adhurim e mëri Amelien:*) U jam këtu!
- URSULLA - E di se je aty: kjo ë e treta herë çë e thua. Bardhyll, çë flet me tyj?
- BARDHYLLI - Këtu nga njeri flet me kë do, ma (por) se ai flet me mua më duket "difiçili" (vështirë)!
- AMELIA - Oh, sa i ëmbël... Oh, sa i fjellët (kthjellët) tingulli i zërit tënd!
- VËRGOLLI - Ma çë je e verbër: u këtu jam!
- URSULLA - (*Kërcen lart nga karrigja.*) U e verbër? Mua vilen (helm) ka më bënj të ngrënit!
- LENA - Ngë flet me ty...
- URSULLA - E atëherë me kë?!
- BARDHYLLI - Fantazi!
- AMELIA - (*Ëmbëlsisht:*) Fantazi! Oh, Bardhyll, si më dridhet kurmi kur të gjegjem!
- VËRGOLLI - (*Amelies*) Ti ka t' e sosësh me këtë Bardhyll!
- BARDHYLLI - "Alura" (atëherë) e ka me mua!
- URSULLA - Ngë t' e thëshja se flet me tyj?
- GJONI - (*Ngrëhet*) Vemi, Amelie, vemi, bija ime! (*E merr ëmbëlsisht për krah dhe e sjell tej derës së brëndshme.*)
- VËRGOLLI - (*Amelies, ndërsa del:*) E në ka vish këtu se ka më lënsosh trutë, më mirë të rrih te angona jote!
- URSULLA - (*E trëmbur, kërcen.*) "Motu" (pika)! Vilen ka më bënj të ngrënit! Këtu ngë mënd rrihet (jetohe) më! E pameta ka vete te shtrati pa ngrënë! (*Del me furi e shkon te dhoma e saj.*)
- BARDHYLLI - "Manku" (as) ca bukë mënd hahet këtu! (*Ngrëhet e del nga dera që jep jashtë.*)
- VINAU - (*Ka qëndruar i heshtur duke duruar. Tani, i mërijtur më shumë se kurrë, ngrëhet e ndërsa shkon te dhoma e brëndshme:*) E kush mënd ju duronj! Ajo lënson (*Tregon të shoqen.*), ky këtu lënson (*Tregon Vërgollin.*): mua ka më lëni "kujetu" (në



paqe) o “mosinò” (ndryshe) veni e mbyllij te spicji (çmendina)! (*Del.*)

- LENA - (*Vë duart në fytyrë*) O mjera u!
- VËRGOLLI - (*Ka vërejtur përherë nga doli Amelia.*) Vanë?
- LENA - Vanë. Nga, si të vjen, biri im!
- VËRGOLLI - (*Duke ndjekur fillin e mendimeve*) Ma çë e pe? Vete i flet Bardhyllit “ajo”! Një fantazmë çë ngë sistir (eksiston) vete i flet Bardhyllit! E u çë kur e shoh bëhem një shkëndijë, mua ngë më vëren!
- LENA - (*Duke vënë në urdhër tryezën:*) “Sia fata!” (U bëftë!) Nga, ti biri im, çë janë këto fantazi çë ke!
- VËRGOLLI - Fantazitë “ajo” i ka, çë rrjedh te Bardhylli!
- LENA - (*Me durim*) Nga, le të rrjedhënj ku do, le të flasënj me kë do: ngë e sheh se ë... një shpirt!
- VËRGOLLI - (*Me mëri:*) “U” e shoh atë, “U” e di sa ë e bukur! Ngë e sheh Bardhylli!
- LENA - O mjera u! vuri “xhullusi” (xheloz) me të vëllain!
- VËRGOLLI - U “xhullus”? U jam “loxhiku” (logjik): gjysmë e ‘shterje (krështerë, njeri) ë “ajo”, gjysmë burri jam u: “ajo” mua ka më detë! (*Vëren përherë derën e brëndshme.*)
- LENA - Ti ngë mënd i kumandarësh (urdhërosh) zëmërës!
- VËRGOLLI - Mënd i kumandar! E pra “ajo” zëmër ngë ka: sheh se u vritem për atë e ajo rrjedh te... (*Imiton Amelien:*) “Oh, çë zër i bukur çë ka Bardhylli! Oh, çë fjalë të qëruame çë thotë!” Më mirë t’ë sosënj! (*Prëhet një thërrime; pastaj, me zë shumë të lartë, citon përmendsh:*) “A! quotiens lacrimis venientibus ora reflexi / Ne causam fletus quaereret mei!” (*Ovidi - Heroides - Paridi Elenës.*) - Ah, sa herë, ndërsa më vijën lotët, prora fixhën (ktheva fytyrën) time sa mosnjeri të më pyej (pyente) përçë klaja (qaja)!
- LENA - O mjera u! Nani zë me “lu greku” (greqishten)!

#### SKENA VIII

LENA, VËRGOLLI, GJONI

- GJONI - (*Hyn nga dera e brëndshme.*) E qella (solla) tek e jëma...
- LENA - Bëre mirë.
- GJONI - (*Vërgollit*) E ti... ngë vete...?
- VËRGOLLI - Ku: te mëma? Mëma ë këtu.
- LENA - (*Gjonit*) Ke bsonjë (nevojë) ndonjë gjë?

- GJONI - (*Qaset te Lena:*) Dishironj të të thom një fjalë; ma (por)...  
(*Tregon Vërgollin.*) në ishëm vetëm...
- VËRGOLLI - E thua për mua? U këtu jam e këtu rri, megjithëse ngë jam këtu, ma ku isht “ajo”...
- GJONI - Mënd rrish në do.
- VËRGOLLI - Dua!
- GJONI - (*Ulet.*) Ngë di si ka zë... Ime bijë sufrir (vuan), ngë ka paqe...
- LENA - (*Ulet e psherëtin.*) Eh!
- GJONI - (*Flet me ëmbëlsi e ngadalë.*) Ju e dini si vajza na u shua nga gjella... E dini si u shuajtëm na... (*Merr frymë.*) Kur ish gjallë vajza jonë u kish dhezur (ndezur) me dashuri për një kopil, djalë i mirë, i rrallë: ishën të dy pasqyra e haresë, pranvera e lumturisë... Përpara ‘tyre qielli, fati ngë kish mjegulla... Ma (por) një ditë e zezë, djali vdes, ashtu pa pritur, pa dijtur si... e prapa atij, vajza dal’ e dalë - ma çë thom “dal’ e dalë! - gjithbashkë, vate tuke u shuar si një qiri, si fitili i llëmbës ku lypset vajt... Na u shua vajza e na, ime shoqe e u, prapa ‘saj... përçë ajo ish gjella jonë ... (*Merr frymë.*) E çë ahierna (atëherë) ngë kemi paqe: qëndruam lidhur me këtë jetë - ajo juaja - megjithëse vdiqëm, megjithëse sufrirtëm (vuajtëm) aqë shumë sa ngë mënd të rrëfyhet. Edhe sot kujtojëm ata mumente të bukur kur të gjithë ishëm të gëzuar e... të gjallë! Vajza kish ca qëro (kohë) çë dukej se kish harruar atë çë i ndodhi kur ish te jeta; ma (por) nani sufrir (vuan) pameta, ngë ka paqe...
- LENA - (*Me pjesëmarrje*) E na çë mënd bëjëm...
- VËRGOLLI - U e di!
- GJONI - Vajza... isht e i nxier trutë t’jëmës e mua se do - si ka e thom - ngëse ë façili (lehtë) të thuhet...
- VËRGOLLI - (*Kupton e nxiton:*) Thuaje, thuaje se ngë ë “difiçili” (vështirë) të thuhet!
- GJONI - E thom....
- VËRGOLLI - Thuaje!
- GJONI - (*Ndërsa flet vëren efektin e fjalëvet që thotë.*) Do... do... martonet!
- LENA - (*Me çudë*) “Sia fata!” (U bëftë!) Nga, mirë!
- VËRGOLLI - (*Me krahët lart, citon me solemnitet nga liturgjia e mbrëmjesores - psalm 140:*) “Κατευθυνθήτω ἡ προσευχή μου ὡς

θυμίαμα ἐνώπιόν σου...” - Le të hipet lutja ime si livan përpara teje...

GJONI - Çë ka?

LENA - Mos e gjegj (dëgjo): flet litisht! Çë ish e më thëshje?

GJONI - Do martonet!

LENA - Mirë!

GJONI - Ti, Lenë, thua se ë mirë; ma (por) ti e di çë familje jemi na!?

LENA - Ngë flitet lik për ju te hora: kini emër të mirë...

GJONI - E di, ma ngë thom për emrin...; thom se jemi një familje ashtu... çë ngë rri as në qiell as në dhe...

LENA - “Né nçelu né nterra!”, si thuhet te Siçillja.

GJONI - E ime bijë do martonet!

LENA - E nga çë ë “di mali” (s’ka gjë të keqe): gjithë vajzat do martonen...

GJONI - E për ju vete mirë se një vajzë si ajo imja të martonet?

LENA - Vajza ë “fine” (shijehollë)..., ngë kam gjë t’i thom...

VËRGOLLI - (*Me emocion*) Kurora: i shtati sagrament!

GJONI - Ma...

LENA - Ma?

VËRGOLLI - Ma: çë?

GJONI - Ma... ë “difiçili” (vështirë)!

LENA - Nga, “çertu” (qartë) se...

GJONI - Ajo ka te kryet, si ka e thom..., do martonj...

LENA - Një si ju?

GJONI - Një fantazmë? Jo, ngë ë fantazmë: ë i gjallë!

VËRGOLLI - (*Me shqiptim të shpejtë:*) Shi’-ku-jam! Shi’-ku-jam!

LENA - “Sia fata!” (U bëftë!) Do një... i gjallë?

GJONI - Për këtë jerdh’e fola me ty!

LENA - E u çë mënd të thom: “çertu” (qartë) ë “difiçili” (vështirë). E kë do?

GJONI - Eh, kë do! (*Merr frymë.*) Do një... çë rri te kjo shtëpi!

LENA - (*E preokupuar, bën kryq.*) “Santi animi decolati!” (Shpirtra të shënjtë kokëprerë!) “Sia fata!” (U bëftë!)

VËRGOLLI - (*Duke u ndezur më shumë:*) Shi’-ku-jam! Shi’-ku-jam!

LENA - (*Tregon Vërgollin.*) Atë?

GJONI - Jo...

LENA - (*Fort e shqetësuar, ngrëhet nga karrigja.*) Eh, nga, çë janë këta diskurse! Nga, këta diskurse janë?



- GJONI - (*Ngrëhet.*) Fantazi fantazmësh!
- VËRGOLLI - (*Me mosbesim e mëri:*) Bardhyllin?! Bardhyllin?!
- LENA - “Motu” (pika)! Qetu ti! “Sia fata!” (U bëftë!) Nga, këta diskurse janë! (*Merr të niset.*)
- GJONI - Më mirë në të kish folur ime shoqe: mëmat ndëlgonen (kuptohen) më mirë; ma (por) ajo ndihej debull (e dobët) sonte.
- LENA - (*E shtangur*) Diskurse!
- GJONI - (*Niset.*) Natën e mirë!
- VËRGOLLI - (*Si i vvarë.*) Bardhylli! Dhëndri!
- LENA - Qetu ti! (*Me fytyrë të vrerët, shtyn karrocelen me të birin gjer në dhomën tjetër e shuan dritën.*)

#### SKENA IX

- GJONI, THODHA, FINA, AMELIA
- GJONI - (*Hyn si zakon.*) Mos bëjëm batari (zhurmë).
- THODHA - (*Hyn pas Gjonit me vendosmëri, vesh petkat arbëreshe anti-ke, por të bardha.*) Më dalë se kështu po t'ishëm... fantazmë! (*Priret, kthehet:*) E jot shoqe ku qëndroi?
- GJONI - Ish prapa meje...
- THODHA - Ia the Lenës? (*Ulet.*)
- GJONI - Çë kish i thëshja? (*Ulet.*)
- THODHA - (*Me vete, për Gjonin:*) Më duke se 'ntamë (budalla) ishe e 'ntamë qëndrove! (*Me zë të lartë:*) Çë kish i thëshje? Për vajzën!
- GJONI - Ia thashë, ma (por) u trëmb...
- THODHA - U trëmb? E se përçë u trëmb! Çë ka t'i thetë vajzës!
- GJONI - Lena ngë thotë gjë për vajzën: u trëmb e...
- THODHA - (*Me vendosmëri:*) E ka sosënj kështu?
- FINA - (*Hyn veshur me një veshë të bardhë stil vite '30. Flet me zë të ëmbël e ngadalë.*) Mos lurini!
- THODHA - (*Me zë të lartë:*) E kush lurin! (*Finës:*) Ti çë ke sonte?
- FINA - (*Ulet.*) Mah, ndihem si fantazmë...
- THODHA - E si do ndihesh!
- AMELIA - (*Hyn pa prituri nga dera e brëndshme:*) Kjo ëndërr çë ngë më lë kurrë e ngë di në ëndrra ë jeta e vërtetë o jeta e vërtetë ë ëndrra!
- GJONI - E kush e di, bija ime!

- THODHA - Eja këtu te nona (gjyshja)!
- AMELIA - (*Ec e lehtë dhe vazhdon me zë poetik:*) Sonte e pashë: “ai” ë si gjaku, ë si gjella... e kur jam ndanëz (afër) atij ndihem e gjallë!
- FINA - (*Mallëngjehet.*) Oh, bija ime!
- THODHA - E gjegjij? Vajza “atë” e do e ka e marrënj!
- GJONI - U i fola Lenës...
- THODHA - (*Me zë të lartë:*) Ti je një ‘ntamë (budalla) e kush e di ç’i the!
- FINA - (*Me zë lutjeje:*) Mo!
- THODHA - Harrova: jini të dy ‘ntamë! Në vajza “e” do - e “e” do! - ka t’ë marrënj!
- AMELIA - Fryma e puhisë ngë ë ashtu e ëmbël si kur më flet ai...
- FINA - Qetu, bija ime, qetu, se më shqier zëmrën!
- THODHA - (*Jep një grusht mbi tryezë.*) Këtu ka flitet si nget, me vjersh!
- FINA - Mos bëj batari (zhurmë) se na gjegjen...
- GJONI - (*Thodhës:*) Mos na fruntar (turpëro) me gjinden...
- THODHA - Fruntar e fruntar: në ngë ishët të dy si kilinjomëra (të njomë)!
- AMELIA - (*Vazhdon me ëmbëlsi:*) E pra më vërejti me ata sy të humbët si qielli i fjellët (kthjellët)...
- FINA - Të vërejti?
- GJONI - I duket se e vërejti...
- THODHA - (*Me vendosmëri:*) Në vajza thotë se e vërejti, e vërejti!
- GJONI - Jerdhi të më gjej kur ish e hajën...
- THODHA - E çë e thua sikurse i nxori bukën nga goja!

## SKENA X

### ATA, VËRGOLLI

- VËRGOLLI - (*Në karrocele, me pizhamin; hyn kërcënues:*) Ju!
- FINA - (*Zmekset, tronditet, si hyn Vërgolli.*) U trëmba!
- THODHA - (*Vërgollit:*) E çë hyn kështu, të spërdarësh (trëmbësh) gjinden!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë e me gisht kërcënues:*) Ajo! Ajo do Bardhyllin!
- THODHA - E ti çë e do kë do!
- VËRGOLLI - (*Me gjetet e duhura orvatet të shpjegojë:*) Ë një shërbes pa krye e pa këmbë...
- THODHA - Kërko të rraxhunarësh (arsyetosh)!
- VËRGOLLI - Jam e rraxhunar; i kam rraxhunartur e më shumë i rraxhu-



nar më shumë trutë më thonë se ë një shërbes pa krye e pa këmbë!

- FINA - Se jemi “in uno stato d’inferiorità” (në gjendje të ulët)?  
THODHA - Na ngë jemi “in uno stato d’inferiorità”? Ëj, zborëm kurmin, ma ime bijë e ime mbesë ishën të parat e Hores; im dhëndërr, ai... mah, si vate vate, ma (por) ngë jemi “in uno stato d’inferiorità”? (*Gjoni e vëren me durim.*)
- VËRGOLLI - Janë diskurse pa krye e pa këmbë. Ju jini “shpirtra”, fantazmë... “të vatur”! Ngë kini më pushtet, “putiri”, te shurbiset materiale, ngë mënd ngini (prekni)! Të ngarit... (të prekurit) kështu (prek kofshën e vet)! Të ngarit ë shënja e gjellës - ti rron e nget, u ngas e jam - këtë ju ngë e kini më...
- THODHA - Mos flit (fol) “difiçili” (vështirë) me ne, se “ormai” (tashmë) din ë gjithqish...
- GJONI - “Kuasi” (thujajse) gjithqish!  
THODHA - Dimë gjithqish!  
VËRGOLLI - Atë çë dini o ngë dini ngë më interesar (intereson), më interesar atë çë ngë kini: të ngarit! Ju ngë mënd ngini! Me trutë thomse mënd i ndërroni vend shërbisevet (gjëravet), ma (por) të ngini jo!
- THODHA - Sa gjegjemi ku do t’arrësh.  
VËRGOLLI - Arrura: ajo (*Tregon Amelien*) ngë mënd martonj Bardhyllin!
- THODHA - E përçë?  
FINA - E përçë?  
GJON - E përçë?  
AMELIA - (*Ndjek fillin e ëndrrave.*) Gjeta lëndë për ëndrrat time (të mia) të holla e të pangara...
- THODHA - E përçë?  
FINA - E përçë?  
GJON - E përçë?  
VËRGOLLI - Përçë Bardhylli ë “materie” (lëndë), çë ngitet: mish eshtra gjak... e “ajo” (*Tregon Amelien*) ë vetëm “un’idea” (një ide)... Si mënd martosh mish eshtra e gjak me një ide?
- THODHA - Mënd!  
VËRGOLLI - Jo, ngë mënd! Bardhylli ka bsonjë (nevojë) të ngasënj, përçë ë i gjallë: çë ka ngasënj tek “ajo”?
- AMELIA - (*Duke lëvizur ngadalë në skenë:*) Ëndrrat janë të ngrënë (ushqim)... bukë te tryeza e zëmërës sime...

- VËRGOLLI - E gjegjij (dëgjoni)? “Ajo” e ka me ëndrrat; Bardhylli do të ngasën! Një çë “ngë ë” ngë mënd martonet me një çë “ë”! Ajo ka martonj...
- THODHA - (*Sulmuese:*) Kë?!
- VËRGOLLI - Mua!
- THODHA - Tyj?
- FINA - Tyj?
- GJONI - Tyj?
- VËRGOLLI - Mua!
- FINA - E ti ngë do, si e the?!, ngë... nget?
- VËRGOLLI - Gjella ime janë trutë. U rronj me trutë: ketu brënda (*Vë dëftuesin te vetulla*) kam jetën time e një mijë tjera! (*Merr frymë.*) Mua më pëlqej të ngisja, ma kujt i pëlqen të më nga-sënj mua?
- THODHA - E jic se e gjen!
- VËRGOLLI - (*Me mëri:*) Ngë e gjenj! Përçë ngë e gjenj? M’e thoni ju kush ë çë do ketë te ana një njeri i shëmtuam e i kopjasëm?
- THODHA - Ngëse je aqë i shëmtuam! (*I pyen tjerëve:*) Ë i shëmtuam?
- FINA - (*Me dyshim*) Ashtu...
- GJONI - (*I përgjithshëm*) Mah! Jo...
- VËRGOLLI - I shëmtuam ë për mua ai çë ngë mënd jetë i lum, “feliçi”; je i sëmtuam kur ngë mënd kesh atë çë do, ngë mënd jesh atë çë do, përçë ke përpara “l’handicap” - si thuhet sot; “handicap” të kurmit, “handicap” të truvet, “handicap” sociali, “handicap” të vjeçvet... e gjithë tjerët “handicap” të jetës (botës): një rreshtë e glatë si rreshtë fiqsh. E kush t’i vuri këta “handicap”? Natyra, ma (por) edhe gjindja, shoqëria, çë të bën i bukur o i shëmtuam përgjithmonë... E te çila shoqë-ri kanë rëndësi - rëndësi të vërtetë! - të shëmtuamit? (*Ngrën edhe më shumë zërin:*) Ju ka më jipni një përgjegje nani o për jetë o për vdekje!
- THODHA - Një përgjegjë? E çilën përgjegje! Ime mbesë bën atë çë do, vëren kë do, do kë do: i lypset se nani - thom “nani” - ngë ë e zonja të bënj atë çë do! Në do të ëndërrinj ka ëndërrinj, në do atë... të bukurin... le t’e detë!
- VËRGOLLI - Oi, oi, oi! Errësira e truvet më merr! (*Rrah me grushte kryet.*) Errësira e truvet!
- THODHA - Na ngë i ftesjëm!
- AMELIA - Nga (çdo) zër çë këndon për mua këndon i përjetshëm!

- VËRGOLLI - (*Me dëshpërim:*) “Οἱ πρὸς ὑμᾶς πάντες παραπορευόμενοι ὁδόν, ἐπιστρέψατε καὶ ἴδετε εἰ ἔστιν ἄλγος κατὰ τὸ ἄλγος μου!” (Jeremia - Elegji e parë, 12) - Oh, ju të gjithë çë shkonit rrugës, kërkonit, vëreni në ndodhet një dhëmbje ç'i glet (ngjan) kësaj times!
- FINA - (*Me një fill zëri:*) Mos lurit (ulërit) kështu, se zgjon gjithnjëri!
- THODHA - (*Vërgollit:*) E, se ngë bie jeta (bota)!
- VËRGOLLI - (*Me rënkim të vjetër:*) Për mua bie jeta, përçë jeta (bota) do më nxierën edhe shpresën, ilusionët (iluzionet) të jem, të ndihem “normali”, megjithëse ngë jam “normali”, përçë kështu leva (linda) nga mëkatët e prindravet e kështu qell barrën e mëkatëve të tyre! (*Ngrën zërin:*) “U”! Jo ti o ti o ti jetri... “U” jam “handicappato” e mosnjëri ka dishirim të veshënj pethkat time...
- THODHA - (*Me vete*) Në këtë herë ngë zgjon gjithë sa janë, ngë zgjonet më njëri!
- VËRGOLLI - E me çilën gluhë ka vajtonj çë ngë kam vajtuar më parë! Çë fjalë lipi ka i shtonj gjithë fjalëvet çë më kanë dalë ka kjo gojë! (*Godit me grusht gojën:*) Oraëj (po), e di: ka i shtonj një fjalë të re: AMELIA!, çë rron te ëndrrat e ngë do dalënj nga ëndrrat! (*Ulërin:*) AMELIA! (*Duke lëvizur me karrigen me rrotele, gorromis ndonjë gjë e kryen një potere të pabesueshme. Fantazmët ngrëhen gjithë shtuara e grumbullohen gjithë te një kënd.*)

## SKENA XI

ATA, LENA, URSULLA, VINAU, BARDHYLLI

- LENA - (*Hyn me linjën nga dhoma e shtratit. Vërgollit:*) Çë ke?! Përçë lurin? (*Sheh fantazmët:*) E ju?
- URSULLA - (*Hyn plot gjumë me linjën e i thotë Vërgollit:*) Nga, çë murmuriare, çë rrungullise! Nga, mënd jetë kurrë se këtu brënda ngë mënd rrohet, ngë mënd flëhet një thërrime? (*Të një kënd u grumbulluan Fantazmët e thujse përballë grumbullohen “të gjallit”. Në mes Vërgollit.*)
- VINAU - (*Me pizhamin.*) Çë kle!? Këndoi gjeli e u gdhi? Çë herë ë! E dini çë herë ë?



- URSULLA - U nes' (nesër) menatë ka vete te "l'ufiçiu" (zyra) e në ngë flë një thërrime, nes' menatë sytë më gdhihen si ve kuku!
- LENA - Qetij, se ngë kle gjë!
- URSULLA - Na ka qetemi? Ai ka qetet, "datu l'orariu" (sipas orarit)!
- VINAU - (*Lenës*) Çë ka?!
- LENA - (*Ndersa Vërgolli rri i përqëndruar te mendimet e tij:*) Çë ke, Vërgo': ndien gjagjë?!
- VËRGOLLI - Flas vetëm...
- URSULLA - E të flaç vetëm gjithë këtë batari (zhurmë) ka bësh? Veshët i ke ndanëz (afër) gojës, e di?
- LENA - (*Pyen Fantazmët:*) Ju ç'i thatë gjë?
- THODHA - Na mosgjë!
- URSULLA - (*Konsekuente*) U ngë i kam thënë gjë veç sa i thashë nani...
- VINAU - (*Hap krabët*) U hyra prapa juve...
- LENA - (*Ursullës e Vinaut:*) Ngë flas me ju!
- URSULLA - E alura (pra) me kë?!
- BARDHYLLI - (*Hyn nga jashtë.*) Çë kle?!
- VINAU - Vë skumis (bast) se ti je mbjidhe (mblidhe) nani...
- URSULLA - Skumisën (bastin) e munde!
- BARDHYLLI - Isha me miqtë e ngë mënd i lëja...
- VINAU - Oraëj, mos zbireshin...
- VËRGOLLI - (*Pa pritur*) Ylli! Ylli! (*Hap krabët në drejtim të Bardhyllit.*)
- VINAU - (*Me mëri:*) Lenë, qill tët bir (Vërgollin) te shtrati, "mosinò" (ndryshe) sonte natën...
- LENA - (*Tregon Vërgollin*) Ai ë si ë e ka i kemi kunsideracionë (përfillje, vëmendje)! (*Vërgollit:*) Çë ke biri im?
- VËRGOLLI - Yt bir ngë ka gjë, veç atë çë sheh, çë ë shumë pë' kë ngë ka "manku" (as edhe) atë çë sheh, e ë pak për më të bukurin e jetës (botës)!
- BARDHYLLI - Trutë jui nisën "di 'ntunu" (plotësisht)!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) Përçë "ajo" (*Tregon Amelien*) ngë do gjegjet!
- AMELIA - Mos më ngini ëndrrat time (e mia)... mos më nxirrni ëndrrat time!
- VËRGOLLI - E gjegjij (dëgjoni)? E gjegjij? "Asaj" i dollën trutë!
- URSULLA - "Asaj": kujt? Ti sheh gjë Bardhyll? (*Lenës e Vinaut:*) Ju shihni gjë?!
- BARDHYLLI - U jo, e ti?

- URSULLA - “Era beddu u vasilicò'...?!”
- AMELIA - (*Bardhyllit:*) Ëngjëlli im!
- VËRGOLLI - (*S' ka nxjerrë sytë nga Amelia:*) “... now at once run on / the dashing rocks thy seasick weary bark! (Shekspiri: Romeo e Zhuljeta - V, III) - Përplase dhe dërmoje mbi shkëmbinjtë anijen *time* lodhur nga futura!” Mjeri u i ziu! Mjeri u i ziu! (*Amelies:*) Mos më le hiret të përmbledhur, ma (por) le t'i marrënj era e t'i shprishënj! (*Ul kryet e me zë të thellë:*) Dishiroja të priresha (kthehesha) te gjiri i mëmës e të mos dilja më!  
(*Të gjithë e vërejnë të tronditur.*)

## AKTI II

### SKENA I

LENA, VËRGOLLI

- LENA - (*Rri prapa karroceles e kreh të birin.*) Kujtonem kur ishe i vogël çë të krihja...
- VËRGOLLI - (*I pëlqen se e jëma e kreh, por nuk e dëfton.*) Ngë kam bsonjë (nevojë) të jem krehur: u di të krihem!
- LENA - Lemë të të kreh: dishiroja të të nxirja gjithë fantazitë e liga me këtë krëhër... gjithë fulliniet (pëlhurët merimangash)!
- VËRGOLLI - I duhen tjerë krëhre. Fulliniet janë abrënda... e jo te kripët (flokët)!
- LENA - Sa pincere (mendime) ke te këta krye!
- VËRGOLLI - E kam aqë plot se me një pincer më shumë skopjar (shpërthen)! Këtu brënda (*Nget-prek kryet*) ë plot me gjinde çë flasjën, plot me thirrma, rëkime, plot me shërtime aqë të fortë se xirriarjën (cijatin) si persianët (grilat) sonte natën kur fryj ajo erë... Plot! (*Me zë të lartë*) E kam plot!
- LENA - U të flas të të kalmar (paqësor) e ti zë fill e 'lurin...
- VËRGOLLI - Ngë jam u çë lurinj, janë trutë: fula e diskursevet çë këtu brënda ngë sosjën kurrë natë e ditë!
- LENA - E ti bëji të qeten. (*Vazhdon të krehurit.*)

<sup>1</sup> Pjesa e parë e një shprehjeje ironike siciliane për të treguar një gjendje që vështirësohet ende më shumë: “era beddu lu vasilicò / vini la gatta e lu scippò” = ish i bukur borziloku / erdh' e e shkuli pra maçoku.

- VËRGOLLI - Në qeten ata, flas u kështu si jam: gjithë një fjalë: i kopjasëm!
- LENA - Ma (por) u, gjithë na, të duam mirë.
- VËRGOLLI - Më do mirë se jam yt bir. Ti e do mirë një çë ë i kopjasëm e çë ngë ë yt bir?
- LENA - Ngë ë paraç (njësor). Për tjerët më dishpëlqen... për tjerët çë janë si ti.
- VËRGOLLI - E sheh? Ti më do mirë, megjithëse jam “kështu”, përçë jam yt bir. Ngë ë një dashuri “universale” (e përgjithshme) për gjithë të kopjasmit!
- LENA - U gjithë këtë barrë ngë mënd e qillja për gjithë! (*Largohet me krëbrin.*)
- VËRGOLLI - Qell barrën time, çë ë rëndë: u e di; ma sa janë të kopjasmit, ata çë kanë difete (të meta) fisiçi (fizike), ma (por) edhe ata çë kanë ndogjagjë ç’i lypset te shpirti o më mirë te “la psiche” (psikika) ?!
- LENA - Biri im, ti flet difiçili (vështirë), ma (por) në gjithë të kopjasmit ngë ishën ndajtur këtu e këtë, kush mënd t’i qillj? U barrën tënde ngë e rienj (ndienj), përçë je ti vetëm... E pran ngë janë gjithë të kopjasëm ata çë thua ti: kanë vetëm gjellën (jetën) difiçili... Ma (por) le këta diskurse se më kunfundir (huton): tyj kush e di kush t’i bëri ato tru!
- VËRGOLLI - Tata e mëma! “Un’acoppiata vincente” (Një çift fitimtar)!
- LENA - Çë ka gjegjem!
- VËRGOLLI - Mos i gjegjesh: flas vetëm e i gjegjem vetëm u!
- LENA - Në ti ishe më i butë, më...
- VËRGOLLI - Më normal...!
- LENA - Ti diskutet i qell ku do ti!
- VËRGOLLI - Vetëm diskutet mënd qell ku dua u, pra’ janë tjerët çë më qelljën mua... (*Tregon karrocelen.*)

## SKENA II

ATA, MIKU, AMELIA

(*I bien te dera.*)

- LENA - Kush ë? Hyr se dera ë zbyllmë (hapur).
- VËRGOLLI - Ka jetë “la radio” (radioja)...
- LENA - Megjithëse ë vërtet si “radio”, të do mirë e të bën vistë (vizitë).
- MIKU - (*Paraqitet.*) Mënd hynj? Vo’ Lenë, Vërgo’: mirë ditë!



- LENA - Mirë ditë. T'uju (ulu).
- MIKU - (*Ulet përballë Vërgollit.*) I di "të sprasmet"...?
- LENA - Më parë se t'i thuash "të sprasmet", më bën pëlqimin (qej-fin) të më thërreç kur vete?
- MIKU - Pa tjetër, Vo' Lenë. (*Vò' Lena hyn në dhomën e brëndshme. Vërgollit.*) Kjo çë ka të thom ë frishku frishku (freskët); ma (por) ti çë ke me këtë çerë (fytyrë e mëritur)!
- VËRGOLLI - Ngë kam gjë e gjithqish, ma (por) për tyj ngë kam gjë.
- MIKU - E më mirë ashtu. Këtu (*Tregon veten*) flet Radio Pasijata (shëtija)! Dje grisëm dy parë këpucë, dy parë sandulla e tri parë pulake tue pasijatur (shëtitur). Ngaherë ata diskurse: "disoccupazioni" (papunësi) e vajza - vajza e "disoccupazioni"; jo se janë vajzat çë japiën "disoccupazioni", se anci (majde, madje) ato e duan "l'occupazioni" (punën), "mosinò" (ndryshe) qëndrojnë... (*Bën gjestin për të thënë "pa mosgjë"*), ma (por) diskurset janë ata: vajza e "disoccupazioni"! Na çë studiarjëm (studiojmë) si nani jemi te "garazhi"...
- VËRGOLLI - Te çili garazh?!
- MIKU - Te "garazhi": *vah*, jemi te "parkexhi": "parcheggiati" e ndëlgon (kupton)? Si nani ngë shërbejëm (punojmë) se ka studiarjëm e nestrë ngë ka shërbejëm se gjithë vendet na i morën! Dje vejëm tuke bërë këta diskurse kur gjithbashkë shohjëm se vjen e na gjen Mariuci. - Mariu' e si kle? Çë e le kacollen (mistrinë)? - i thashë u. - E lashë! - u përgjegj ai. Ti e di se bën, bëj, muraturin. - E, nga, si e le?! - i pyeja u. - E lashë e basta (mjaft)! - E shërbëtyra? - Çila shërbëtyrë?! - bën ai. Kish lënë të bëj muraturin se thotse dej (donte) pasiarëj (shëtiste) si na studentë. - E u çë jam babasun (budalla)? Ju rri gjithë ditën tuke pasijatur e u ka shërbenj? - E ndëlgon tru? (*Merr frymë.*) E pra' "të sfutirturit" (të vënit në lojë)! Ti e di se kur sheh tre vetë bashkë, dy jan' e sfutirjën të tretin! Xhuani prëmë (mbrëmë) sfutirëj Gjergjin me ndihmën e Vitucit se thotse vajzën e tij, Pipinelen, ky Gjergji e vëren po te sytë e i arrën t'e detë mirë; përçë Gjergji nani (tani) u vu me Pipinelen, çë më parë ish vënë me Gasparinin te grupi i Maria Konçetës; te grupi ynë nani hyri edhe Marieja, çë isht e i lë sytë të vërenj Xhuanin, ma Xhuani ngë ka ata krye e ia thotë qaru (qartë): miq e "basta"! Marilena do Pierun, ma Pieru do Katarinën; ma (por) jo se e do, e do

se ka t'i flasënj në i huan një disk të Vasko Rossi-t! (*Qesh:*) Ah, ah, ah! E ti ngë qesh? (*Vërgolli buzëqesh pak.*) Eh, "sta gioventù moderna" (kjo djalëri moderne)! Ti e xure se jiku një vajzë trembëdhjetë vjeç me një djalë çë ka bënë tetëmbëdhjetë! "Bella gioventù moderna" (bukur djalëri moderne)! Nona ime jiku trëmbëdhjetë vjeç me nonin tetëmbëdhjetë: çë ka ndërruar! Ma (por) na jemi "moderni"! (*Pauza. Miku vëren Vërgollin në fjalimi i intereson. Vërgolli dëgjon në mendime e rri pa tundur.*) E "la politica" (politika)? Janë djem çë kanë kryet te "la politica", ma të shumtit çë bëjnë? "La politica" si nani ë bsonja (nevoja) e bsonja ndërron ngaditë... Nani thonë se jec "u spinellu" (droga); u ng'e kam parë të jecënj se ngë kam ata krye, ma thotse jec... Gjithë këta probleme, kur ngë të ngasjën (prekin) drejtpërdrejt, ngë duken probleme tatësh (të tu)... Jemi gjithë "handicappati", Vërgo', kush te trutë e kush te kurmi...!

(*Hyn Amelia e Vërgolli e vëren me gojë hapët.*)

- VËRGOLLI - (*Mikut:*) Qetu!
- MIKU - E çë thashë!? Thashë vetëm se jemi gjithë...
- VËRGOLLI - (*Me frymëzim*) Qetu! Ngë ë për atë çë thua ti; ma (por) për atë çë shoh u!
- MIKU - (*Vëren rrotull.*) E çë sheh?! U ngë shoh gjë, veç neve dyve...
- VËRGOLLI - (*Amelies, që ecën e lehtë:*) Më nxore frymën e shpirtit me bukurinë tënde!
- MIKU - (*Ngrehet me vrull nga karrigja:*) Kush?!? Ei, Vërgo', e nani çë të zë!?
- VËRGOLLI - Te të jecurit, te të folurit, te gjithë lëvizjet çë bën, edhe kur merr frymë, ti ke një hijesi çë më bën të dalënj i lënë!
- MIKU - (*Vëren përçark si për të lypur ndihmë:*) Ei, ei! Vo' Lenë! Vo' Lenë! (*Thërret Lenën më parë dal' e dalë, pastaj më fort, ngjer që ulërin:*) Vo' Leenë! Ku je!? (*Largonet nga Vërgolli.*)
- VËRGOLLI - (*Me frymëzim*) "She walks in beauty, like the night / Of cloudless climes and starry skies...!" (G. G. Byron) - Ajo jec, me bukuri e veshur, si nata e horëvet pa mjegulla e qiej plot me yze (yje)...!
- AMELIA - Kërkonj atë çë rri larg meje... të bukurin..., të fortin...
- VËRGOLLI - (*Amelies:*) Me tyj flas (*Miku bën gjestin: me mua?*) çë bën sikurse ngë jam te kjo jetë me mish e eshtra, me gjak e zër! Me tyj flas!



- MIKU - (*Largohet më shumë.*) Me mua?!? Mi...!!! Vo' Lenë, Vo' Lenë, Vo' Leeeeenëëëë!!!
- VËRGOLLI - Fantazitë që ke janë për mua zjarre të gjallë që më përvëlojnë...
- MIKU - (*Bën për të dalë jashtë.*) Vo' Leeenëëë! Vo' Leeeeenëëëë!
- AMELIA - Kini parë të shkonjë i hjesmi... i miri... i forti im...?
- VËRGOLLI - Qetu! Rri pa folë! (*Mbyll veshët me duart.*)
- MIKU - U ngë flas më e bën be se ngë dua flas kurrë më: "altru" (për hiç më) se Radio Pasijata (shëtitje)!
- AMELIA - Më thoni ku e patë? I thoni ku më patë? Të përpiqemi (takohemi)...!
- VËRGOLLI - (*Amelies:*) Nga (çdo) fjalë ë një thikë te misht tim! Qetu! Ndërroi ato tru!
- MIKU - Bën be, se i ndërronj! (*Si i dëshpëruar:*) Vo' Lenë! Vo' Leeenëëë!

SKENA III  
ATA, LENA

- LENA - (*Hyn me vrap*) Këtu jam!
- VËRGOLLI - (*Këndon këngën fetare të njohur arbëreshe:*) E pasosme... isht lipisia e tij... aliluja!
- MIKU - Vo' Lenë: zuri ashtu gjithbashkë!
- LENA - Ashtu zë.
- MIKU - Ma (por) që ka?!
- LENA - U namurar (u mor me dashuri)!
- MIKU - Mih...! E bën kështu? E u që dje mbrëma putha dhjetë herë vajzën time, që kish bëja?
- LENA - Ë amuri e amuri... (dashuri)
- VËRGOLLI - Aliluja... e pasosme... isht e pasosme... e pasosme...
- MIKU - U 'nkantar (qëndroi) disku!
- LENA - (*Mikut*) Më bën pëlqimin (qejfin) të më thërreç papa Thanasin të vinjë e i thetë një parkalesi?!
- MIKU - Papa Thanasin? Vete!
- AMELIA - (*Mikut*) O ti kopil, i thua Bardhyllit... të fortit, të bukurit, se u jam këtu?
- LENA - (*Amelies*) Qetu, se ai ngë të gjegjet!
- MIKU - Kush? Papa Thanasi? (*Me vete:*) Më parë më lyp t'i thërres papa Thanasin e pra thotë se "ngë më gjegjet"!
- LENA - (*Mikut*) Jo, ngë flisja me ty; thërritëm njize (shpejt) papa Thanasin!

- MIKU - Në ë te shtëpia, më parë! (*Del me vrap.*)
- VËRGOLLI - (*Me frymëzim Amelies:*) “Chi inventò la tua flessibile figura, ha toccato con le mani un luminoso mistero”! (S. Esenin)
- Kush figurën tënde të përkulshme shpiku, me dorë ngau (preku) një mister të ndritur!
- LENA - (*Amelies*) Si kle çë më këtë herë ndodhe këtu?
- AMELIA - E kam kërkuar..., e kam pritur...
- VËRGOLLI - Ë pa zëmër, ë pa zëmër!
- LENA - (*Me gjestet e duhura shoqëron fjalët:*) Amelie, kërkoje atej, lart, poshtë, kërkoje ku do, ma (por) le kujetu (në paqe) këtë djalë (*Tregon Vërgollin!*)
- VËRGOLLI - (*Me shqetësim*) Jo, kujetu, jo! Më mirë të më djegënj se sa të më lënj kujetu (në paqe)!
- LENA - (*E shoqëron butësisht drejt derës së brëndshme.*) Amelie, kërkoje atej!
- AMELIA - (*Ndërsa vete:*) Gjella ime ë Bardhylli... i forti... i miri...
- LENA - (*Sapo kthehet*) Ajo zbori trutë, ky (*Tregon Vërgollin*) zbori trutë e na ka mbahemi të fortë!
- VËRGOLLI - (*Në përgjegje të Amelies:*) Bardhylli! Thuaj gjithë emret çë do, ma (por) atë jo!
- LENA - E përçë: ai ë emri i tyt vëllai!
- VËRGOLLI - U ngë kam vëllezër!

#### SKENA IV

ATA, BARDHYLLI, AMELIA

- BARDHYLLI - (*Duke u kthyer te shtëpia, thuhet nga pragu:*) E sheh, mo', kush ë çë zë sharrë (grindje)?!
- AMELIA - (*Hyn nga dera e brëndshme. Bardhyllit:*) Gjegja (dëgjova) tingullin e zërit tënd, o psherëtimë e zëmrës sime!
- VËRGOLLI - Komploto! (*Këndon:*) Aliluja! Aliluja! Aliluja!
- BARDHYLLI - E gjegje (dëgjon), mo'!
- LENA - T'ë bën aposta (apostafat)...
- BARDHYLLI - Nga, si ngë mënd vë këmbë te shpia se ai...
- AMELIA - (*Bardhyllit:*) Të kam kërkuar, të kam pritur!
- BARDHYLLI - (*Lenës*) E pra' strote (zotrote) më thua se ngë rri kurrë brënda! Manku (as) qëroin (kohën) të hynj se ai zë... spicjin (çmendinë). Më mirë të rri te qaca (sheshi)!
- LENA - O, se nani ti rri te qaca për tët vëlla! Vëre' në ka vësh kryet te vendi: gjithë e gjejën çë ka bëjën e ti...

- AMELIA - (*Si në vazhdim:*) Ti je si era e ëmbël kur ë e ëmbël...
- LENA - (*Amelies:*) Ankora (akoma) këtu je?
- BARDHYLLI - E ku ka vete! E sheh se ngë më do brënda?!
- LENA - (*Bardhyllit:*) Ngë flisja me tyj.
- VËRGOLLI - Πίμπρημι πίμπρημι πίμπρημι! Zë zjarr zë zjarr zë zjarr! Alilujaaaa! Alilujaaaa! Alilujaaaa! (*E del me vrap duke rrotulluar me duar rrotat e karroceles. Shkon në dhomën e brëndshme.*)
- BARDHYLLI - (*I hutuar, vazhdon me Lenën:*) E me kë flisje, me Vërgollin?
- LENA - Ngë di më çë thom e me kë flas!
- BARDHYLLI - Ma (por) ç'isht e ju zë!
- LENA - Kujt?!
- BARDHYLLI - Juve dyve, të treve, të gjithëve!
- AMELIA - Gjithë erërat e ëmbla i ndienj këtu çë më shkundjën gjirin!
- LENA - (*Me veten*) këtu brënda ngë mënd flitet më! Në flas me atë (*Tregon Amelien*) më përgjegjet ai (*Tregon Bardhyllin*)! (*Me zë të lartë:*) Këtu brënda ngë mënd flitet më!
- BARDHYLLI - Jam e vete rri te qaca (sheshi)!
- AMELIA - E mua? Ngë më qell bashkë?
- LENA - (*Amelies:*) Rri aty!
- BARDHYLLI - Ka rri këtu? E të bënj çë: abilji (nerva)? Te qaca rri kujetu e paçifiku (në paqe)!
- AMELIA - (*Bardhyllit:*) Mos veç, avulli im, shpirti im!
- LENA - (*Bardhyllit:*) Jic, jic e vër kryet te vendi!
- BARDHYLLI - (*Me veten*) Kur dua rri u jashtë ngë duan ata e kur duan ata ka dua edhe u: manikomji (çmendina)! (*Del, ndërsa Amelia i zgjat së largu krahët sikurse do ta mbajë.*)
- AMELIA - Vinj me tyj!
- LENA - Te ku ka veç ti: jic te jot'ëmë. (*Psherëtin:*) Mjerët ne, çë ngë kemi paqe manku (as) kur shkojëm mbatanë!
- AMELIA - U e dua Bardhyllin! (*Shkon te dhoma e brëndshme.*) U e dua Bardhyllin!
- LENA - E di e di: në ish vetëm ky... ma kemi jetrin! (*I bien te dera.*) Kush ë?!

## SKENA V

### LENA, PAPA THANASI

- P. THANASI - (*Veshur si do zakona e priftravet bizantinë, mban librin e lutjevet në dorë. Hyn e deklamon:*) Çë kish Bardhylli i Kastriotit me atë çerë (fytirë e mëritur)!



- LENA - Papa Thanasi, ë pa shërbëtyrë (punë) e ng'i pëlqen...
- P. THANASI - E kujt i pëlqen! Megjithëse janë kopij të çilëvet i pëlqën të jenë pa shërbëtyrë, përçë te vendi i tyre shërbejën i jati, e jëma, e motra, noni (gjyshi) e nona (gjyshja)... Përçë më thërrite?
- LENA - Një parkalesi (lutje) djalit...
- P. THANASI - Të gjenj shërbëtyrë?
- LENA - Jo Bardhyllit; Vërgollit!
- P. THANASI - Çë ka nani (tani)!?
- LENA - Plikacionë (huqe): u namurar (u mor me dashuri)!
- P. THANASI - U namurar? Mirë! Gëzonem: edhe ai ka të drejtë të namuraret!
- LENA - Eh, ngë ë façili (lehtë)...
- P. THANASI - Ngë ë façili çë?
- LENA - Nga, se një t'i namuraret njëi... (*Merr skamandilin e fshin ndo lot.*)
- P. THANASI - E kujt ju namurar! Për gjithqish gjëndet mediçina (ilaçi)!
- LENA - Këtu ë difiçili (vështirë) të gjëndet...
- P. THANASI - Vajza ngë ju pëlqen? Ka difete (të meta)?
- LENA - Vajza ë e mirë; difete (të meta) me të vërtetë ngë ka; ma (por)...
- P. THANASI - Ma (por)?
- LENA - Ë një... si thuhet... (*Me dorë nënvizon dyshimin.*)
- P. THANASI - Një vajzë "di facili costumi" (me kostume të lehta)?
- LENA - Jo, jo! (*Me pëshpëritje:*) Ë... ë... një... shpirt!
- P. THANASI - Një shpirt? Më thërrite për tët bir o për tyj? Një shpirt: çë do thuash?
- LENA - Një shpirt... një fantazmë... Te kjo shtëpi rri edhe një familje spirdrash!
- P. THANASI - (*Hap librin e e mban me të shtrëmbren - të majtën, ngren të drejtën e zglesh-lexon si te lutjet e fshehta:*) ... καὶ... καταζῶσον... ἐπίβλεψον... τῶν ἀμαρτιῶν... καὶ ἐλέησον... αὐτοῦς... τῶν αἰώνων...
- LENA - (*E ndalon me dorë së largu:*) Jo, pë' tim bir e thërrita, megjithëse kemi bsonjë (nevojë) të gjithë...
- P. THANASI - (*Mbyll librin.*) Ma e ndëlgon çë më thua?
- LENA - Fantazmë! Ma (por) janë të butë, gjinde të mirë...
- P. THANASI - E ti i sheh?
- LENA - I shoh u e im bir... i kopjasm.

- P. THANASI - Ah! E ai u namurar vajzës? Përçë ë edhe një vajzë... te fantazmët! Eh?
- LENA - E bukur shumë.
- P. THANASI - E ju jini dakord të... (*Bën gjestin si për të thënë "të mirren".*)
- LENA - Nga, çë thotë, Papa Thanasi...
- P. THANASI - Çë thom u? Çë thua ti! (*Mërzitet.*) Thërrite djaloshin!
- LENA - (*Vete te dera e brëndshme e thërret të birin:*) Vërgo! Eja këtu. (*Kthehet e pret.*)

## SKENA VI

### ATA, VËRGOLLI

- VËRGOLLI - (*Hyn e deklamon:*) Ελέησον με - κύριε - κατὰ τὸ μέγα ἔλεος σου...! (Psalmi 50) - Ki mëshirë - zot - sipas mëshirës sate...! Oh, Papa Kliçet-e-Parrajsit!
- P. THANASI - E kush ë papa Kliçet e Parrajsit?
- VËRGOLLI - Zotrote: Papa Kliçet e Parrajsit! Përçë yn'Zot juve ju la gjithë kliçet (çelësat) e neve na la topët (bravat): ju vëni kliçin te topa e dera zbyllet; kur ngë zbyllet atëherë topa ë e sëmurë e kur topa ë e sëmurë besa o rritet o vete fshihet! Përçë gjithë diskursi ë: besa! Ti ke besë? E atëherë thuajmë: "ngreu e jic!", papa Kliçet-e-Parrajsit thuajmë: "ngreu e jic!" E në m'e thua, u jec aqë se ngë më sheh më me kursat (rendjet)!
- LENA - E gjegjet, papa Thanasi, e gjegjet?
- P. THANASI - (*Bën gjestin gruas të qetet e të shkojë andej. Lena shkon në dhomën e brëndshme.*) Besa! Thua mirë!
- VËRGOLLI - "È chiaro" (qartë) se thom mirë: besa! Zotrote ke besë?
- P. THANASI - M'e thua mua?
- VËRGOLLI - Oraëj (po)! I duhet vetëm një besë kështu... sa një koqe sinapi o më mirë xhurxhullenje (susami), çë më pëlqen më shumë! Kush ka besën sa një koqe xhurxhullenje mënd i ndërronjë vendin malevet! Xhurxhullena, ajo çë vëhet asipra (sipër) bukës! Ajo! Zotrote e ke xhurxhullenën?
- P. THANASI - Ti më pyen mua; e ti e ke? Edhe kur t'e kisha u e ti të mos e kishe këtë besë, çë bën?
- VËRGOLLI - "Kush ia vë çançanelen (zilezën) maçes"? Thuajmë vetëm: "ngreu e jic!" Një koqe xhurxhullenje çë bie te mësalla e tryezës! Më pyen në e kam u besën! Besa ime ë "ngreu e jic" o aty ndanëz (afër)! Ngë e kam sa një koqe xhurxhullenë besën, e

kam sa një pushje! Jo, pushja ë e rëndë...; sa një hje (hije) pluhuraci (pluhuri), sa një koqicele të rërës më të hollë larë nga dejti: m'ë vogël!

- P. THANASI - Te "la situazioni" (situata) jote besa i duhet...  
VËRGOLLI - Façili (lehtë)! Besa! E kur të kem besën e ngë kam tjerat shërbise?
- P. THANASI - Me besën ke gjithqish!  
VËRGOLLI - E jo, i dashur papa Kliçet-e-Parrajsit, e jo "caro Papa Chiavi-del-Paradiso"! Ngë kam gjithqish! Për shembull shëndetën; për shembull dashurinë, "l'amuri"...
- P. THANASI - Për shëndetën: ë ajo çë ë; për dashurinë: ke dashurinë e sat'ëmje e tyt eti e sat motrje e tyt vëllai e...  
VËRGOLLI - ... E lalëbukurit, e vovit, e nuses, e motrëmëmës, e kushëriut: ngë thom këtë!
- P. THANASI - E çë andaj!?  
VËRGOLLI - Eh, "considerando la situazioni" (duke shqyrtuar situatën) - duket se një thotë babari (budallallëqe) - ma përçë i kopjasma ngë ka të drejtë...?
- P. THANASI - Dal'e dalë: mos rriht!  
VËRGOLLI - (*Duke qeshur:*) Mos rriht: ah, ah, ah! E kush tundet! Atë çë mënd bënj - shumë shumë, eh? - ë dy kilometre ora: kjo karrocele vete me fuqinë e dejvet ... të krahut!
- P. THANASI - (*Duke rimarrë diskursin e mëparshëm:*) Ngë ka të drejtë për çë?!
- VËRGOLLI - (*I menduar*) Ngë ka të drejtë të ketë dashurinë e...  
P. THANASI - Njëi vajzje!  
VËRGOLLI - Zotrote si e di?
- P. THANASI - Ashtu, më shkoi për krei (kokë)!  
VËRGOLLI - Krye të mirë, papa Kliçet-e...  
P. THANASI - Le "kliçet" se mosnjeri do të të mbyllënj!  
VËRGOLLI - I mbyllur jam; dua kliche çë zbylljën e jo... "klice" çë...  
P. THANASI - Flit (fol) për këtë "vajzë" çë do...  
VËRGOLLI - E si ka flas: u çë gjenj fjalë! Kur e shoh më mirren sytë, e sytë, çë janë dritarja e truvet, më bëjën t'errët gjykimin ashtu se gluha flet vetëm... Çë fjalë do të gjegjesh për "atë"...
- P. THANASI - Në ë një vajzë e krështerë, e butë, çë të do mirë "kështu si je"; përçë disa herë shpirti ë m'i bukur se kurmi e pra kush e di... në vajza ë e krështerë e e "gjallë"...!  
VËRGOLLI - Si "e gjallë"? Çë do thuash me këtë "e gjallë"...?



- P. THANASI - E gjallë: çë merr frymë, ha, flë... e zgjonet: “e gjallë”!  
 VËRGOLLI - Γνωθι σουτόν! - Njih veten! Papa Kliçet-e-Parrajsit!  
 Γνωθι σουτόν!
- P. THANASI - Zbyll zëmrën tënde si me tët ëmë!  
 VËRGOLLI - Ajo t’i tha gjithë këto: ajo çë më vuri te jeta si një mëkatë shekullore! (*Rimerr:*) E gjallë? Kush ka jetë e gjallë?
- P. THANASI - Vajza jote  
 VËRGOLLI - E zotrote ndëlgon (kupton) se një vajzë “e gjallë” mënd më det mua?!
- P. THANASI - Edhe “ajo” çë ‘ndërrin ti ngë të do!  
 VËRGOLLI - Gjithqish i tha ajo çë më vuri te jeta! Përpara Kliçevet-të Parrajsit ka thuhet gjithqish!
- P. THANASI - M’e tha sa të të ndihja.  
 VËRGOLLI - Kështu ngë më ndih; përçë edhe kur të më thëshje “ngreu e jic” u ngrëhesha e vej’ e gjeja atë...
- P. THANASI - Ti je i dejmë (dehur), vëllauthi im, ngë je i kopjasëm! Ë një limtë (kufir) misterioz çë ndan gjellën nga mortja. Janë njëra kundra jetrës e ngë mënd kenë lidhje fizike; lidhjet ideale o shpirtërore mënd t’i kenë, “mosinò” (ndryshe) na ngë kujtojëm të vdekurit tanë, ma (por) ngë veheet më atej!  
 VËRGOLLI - Ëj, ma (por) zotrote ng’e ke parë e thomse ngë mënd e shohësh kurrë! I duhen sy të vërehet: sa ë e bukur, sa ë e hjeshme, sa ë e rrallë kur tund buzët, kur lëviz dorën, kur bën atë gaz çë ka një hje (hije) dëshpërimi, jo, thomse jo dëshpërimi, thomse e hidhët... “amara”, ëj! - e sytë?! U kam parë tek ata sy gjithë atë çë ngë kisha parë kurrë!
- P. THANASI - Ëj, ma (por) ngë të “do”! E ke sa e harron, megjithëse problemi ngë sistir (eksiston), përçë “ajo” ë... e vdekur!  
 VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) E gjallë ë! (*I frymëzuar:*) Flet gëzonet qesh kla (qan) jec oh! jec e lehtë si një ëngjëll...
- P. THANASI - Ma (por) ngë të do!  
 VËRGOLLI - Ngë më do? Ngë më do se ngë ka tru: u jam gjymse burri e ajo ë gjymse.....
- P. THANASI - Thua mirë: ajo ë gjymse përçë ë “shpirt” e shpirti pa kurm ë gjymsa e një të ‘shteri (krështeri).  
 VËRGOLLI - Mënd jetë kurrë se ngë mënd kem edhe një fantazmë? Këto dy gjymsa ngë mënd bëhen një?!
- P. THANASI - Jo! Nga njeri nesh dishiron fantazmët e tij, çë pran ngë janë fantazmë të vërtetë...

- VËRGOLLI - Jo? Edhe “kliçet” më vuhet kundra; çë sa ka çë zuri “fakti i kliçevet” kemi pasur kifari (punë) më shumë me fantazmë, se me të ‘shterë (krështerë) gjithë eshtra e mish! E nani e ka me mua!
- P. THANASI - Ky diskurs ngë i hyn; këtu flitet për tyj e si ka bëjëm të të prisgodhirjëm (bindim)...
- VËRGOLLI - U ngë dua prisgodhirtur (bindur)! “Atë” ka prisgodhirmi: Amelien!
- P. THANASI - Ah, i thonë Amelie!
- VËRGOLLI - (*Ul kryet e zërin:*) “Ajo” do... tim vëlla!
- P. THANASI - Bardhyllin e Kastriotit?
- VËRGOLLI - Ky emër më gjëmon te trutë!
- P. THANASI - Ë emri i tyt vëllai!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) U ngë kam vëllezër!

## SKENA VII

ATA, BARDHYLLI, AMELIA

- BARDHYLLI - (*Vjen nga jashtë; ka dëgjuar:*) U thom: nga, manku (as) qëroin (kohën) të vë këmbën te ënti (pragu) i derës se jam pritur kështu!
- P. THANASI - (*E pret me gëzim:*) Bardhylli i Kastriotit!
- VËRGOLLI - (*Mbyll veshët.*) Gjëmë! Mos e thuaj ashtu fort (me zë të lartë) se edhe muret kanë veshë! E zëri atej ndihet...! (*E thotë për Amelien.*)
- BARDHYLLI - Çë tha fort?!
- P. THANASI - Thashë: Bardhylli i Kastriotit!
- VËRGOLLI - Arrën të thuash vetëm ashtu: (*Tregon dhomën e brëndshme.*) atej ndihet e ndonjeri... lëviz!
- AMELIA - (*E në të vërtetë hyn. Bardhyllit:*) Oh! U prore (ktheve) i dashuri im! Ishe këtu e u ngë dija gjë!
- VËRGOLLI - E çë ju thashë!
- BARDHYLLI - Çë the!
- AMELIA - (*Në përgjegje Bardhyllit:*) Thashë: u prore i dashur...
- VËRGOLLI - (*Ndizet, tregon Bardhyllin e flet me Amelien:*) Ai ngë të gjegjet: po u të gjegjem!
- BARDHYLLI - (*Konsequent:*) Papa Thanasi ë i shurdur?
- P. THANASI - (*Vërgollit*) i shurdhur u? Llodhar (lëvdvoj) t’ën Zonë, i gjegjem mirë!
- BARDHYLLI - (*Tregon Vërgollin e flet me Papa Thanasin:*) Ai tha se zotro-



te, Papa Thanasi, ngë më gjegjet, se më gjegjet vetëm ai; e ngase u ngë dua të jem gjegjur nga ai, jam e vete! (*Bën të niset për jashtë.*)

- VËRGOLLI - Jic!  
AMELIA - Mos veç! (*Thotë njëzëri me Papa Thanasin.*)  
P. THANASI - Mos veç!  
VËRGOLLI - E çë u vutë dakord? (*Amelies:*) Amelie: përpara Kliçevet-të-Parrajsit këtu, gjegjem një bukur herë...  
BARDHYLLI - (*Me durim*) I zuri!  
P. THANASI - I zuri çë?!  
BARDHYLLI - (*Me pakujdesi:*) Lënësia e tij! Flet vetëm o bën sikurse flet vetëm.  
VËRGOLLI - Amelie: Papa Thanasi thotë se ti je shpirti e u jam kurmi...  
P. THANASI - U ngë thashë ashtu... Ma (por) me kë flet?  
BARDHYLLI - U ngë dua mbishkarem (përzihem)!  
AMELIA - Bardhyll, i dashuri im, i ëmbli Bardhyll...: këtu jam!  
VËRGOLLI - (*Me zë të lartë, Amelies:*) Jic, jic atej! Jashtë, jashtë! Jic!

## SKENA VIII

ATA, LENA

- LENA - (*Hyn e shqetësuar.*) Kë dërgon jashtë: papa Thanasin?  
P. THANASI - Ngë e ka me mua; ma (por) duket se e ka me ndonjeri...  
LENA - (*Sheh Amelien.*) Pameta këtu ti!  
BARDHYLLI - Kush u?  
LENA - (*Bardhyllit*) Ngë flas me tyj! (*Bardhylli ngrën supet si për të thënë "është normal" që e jëma të flasë ashtu.*)  
VËRGOLLI - (*Apokaliptik:*) Zjarr e pluhur te baji (oborri) i zëmrës sime, shi me kripë te rahji (kodra) i truvet time!  
BARDHYLLI - (*I mërzitur*) E mos lurij!  
AMELIA - Mos lurij se më trëmp... mua e të mirin tim...  
VËRGOLLI - U 'lurinj sa dua, përçë ti je e shurdhër e e verbër... Ke vetëm atë gojë mjajti m'e mprehtë se një thikë (*Rregullon zërin:*) e ke atë fytyrë m'e butë se butësia e ë ky shërbes çë më ndez: bukuria jote më lë në angështim (ankth) të madh kur je llargu e ngë të shoh; e më shqyerr zëmrën kur më je përpara syvet, përçë më thua me duar, me sy, me gojë se u ngë të 'nteresar! (*Këndon:*) "E pasosme isht lipisia e tij: aliluja!"  
LENA - Papa Thanasi: thuaji parkalesinë...  
P. THANASI - (*Hap librin me shpejtësi dhe lexon duke u murmurisur:*) ...

Σὺ εἶ... Θεὸς... ἡμῶν... καὶ... ἐκούσιον... ἄφεισιν... πᾶν  
πλημμέλημα... αἰτησώμεθα...

- AMELIA - (*Flet ndërsa prifti vazhdon lutjen.*) Dishironj një thërrime paqe, megjithëse në gji më digjet lufta e dashurisë. Bardhyll i dashur, u vete atej të gjegjem (dëgjoj) luftën e zëmrës... (*Shkon në dhomën e ngjitur.*)
- VËRGOLLI - (*Amelies:*) Ai ngë të gjegjet, ai ngë të sheh, ai ngë të pincar (mendon)! (*Thotë duke u referuar Bardhyllit.*)
- P. THANASI - (*Kupton ndryshe.*) Ai (*Me gisht tregon qiellin për tën' Zonë:*) të gjegjet, Ai të sheh, Ai të pincar!
- LENA - I madh'yn Zot, "sia fata" (u bëftë)...!
- BARDHYLLI - Shtëpia e të lënëvet!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë Amelies:*) Jic, jic atej "përgjithmonë"! Pameta (përsëri) i mundur! Pameta i mundur! (*Duke shkundur kryet:*) "Flere liçet çerte; flendo diffundimus iram"! (*Ovidi: Heroides - Hermione Orestit*) - Dua jipem të kla (qaj) e tuke klarë të shuanj jirën (inatin).
- LENA - Klaj, klaj, biri im!
- P. THANASI - ... συνεχόμενος... πειρασμοῖς... καὶ γὰρ... φιλά-  
νθρωπος...
- VËRGOLLI - Jo, ngë kla: m'u tertën sytë e lotët më bien të thata! (*Shkund kokën e bën të lënin-çmendurin.*)
- P. THANASI - (*I afrohet e me të drejtën i mban kryet:*) ... ὀφλιμάτων...  
ἡμῖν... δωρήσασθαι...
- VËRGOLLI - Lemë! (*Kërkon të lirojë kryet, por papritur paqësohet e ul kokën sikurse flë.*)
- LENA - (*Shqetësohet*) Ç'i bëre djalit, papa Thanasi: çë i forte (e godite)?
- P. THANASI - (*Largohet*) Jo, çë thua! I vura dorën mbi krye, ng'i forta (godita)! Parkalesia (lutja) i bëri mirë: nani u kalmar (u paqësua)...
- BARDHYLLI - (*Me mërzitje*) U e kisha kalmartur (paqësuar) me dy shplaka!
- LENA - Ki' një thërrime kunsideracionë për tët vëlla!
- BARDHYLLI - Isht (është) e na bën të gjithë të lënë...!
- LENA - Ai ndien shërbise çë na ngë ndiejëm, ë vërtet papa Thanasi?
- P. THANASI - Ashtu duket. Ka bsonjë (nevojë) dashuri: dashurinë tuaj e

të ndonjë... (*Psherëtin për të thënë: vajzje*); ma (por) u ngë shërbenj te "un'agenzia matrimoniali" (agjenci për martesë), andaj ka i pincarrni (mendoni) ju për këtë shërbes. "Eventualmenti" (eventualisht) një vajzë... "e gjallë"!

BARDHYLLI

- E gjallë?

P. THANASI

- E zgjuar..., me trutë te vendi, vah!, çë di me kë ka kifari (punë)...

VËRGOLLI

- (*Tundet pak.*) Eh...

LENA

- (*Bardhyllit*) Qille atej; le të prëhet e mos e zgjo'...

VËRGOLLI

- (*Ndërsa i vëllai e shoqëron te dhoma e brëndshme, ngrën pak kokën e me vete thotë:*) Në ng'i ftoja (dëftoja) se kalmaresha (paqësoshesha), papa Kliçet-e-Parrajsit ng'e sosëj (mbaronte) më!

BARDHYLLI

- (*Ndërsa shtyn karrocelen e shkon te dhoma tjetër:*) Dukemi o jemi gjithë të kopjasëm?

LENA

- Papa Thanasi, çë ka bënëj?

P. THANASI

- Ka parkalesjëm (lutemi). U mënd i kem kujdes për shpirtin e njëment e pe se e bëra, jatroi mënd i ket kujdes për kurmin; ma (por) gëzimin mënd ia japënj vetëm një... (*Psherëtin për të thënë: vajzë.*) E thashë u ngë shërbenj te "un'agenzia matrimoniali"! Ka parkalesjëm! (*Afrohet derës së jashtme.*)

LENA

- (*E shoqëron.*) Sa kam parkalesur!

BARDHYLLI

- (*Hyn nga dhoma tjetër e menjëherë del nga dera e jashtme.*) Jam e jik pameta... te qaca! Ëm uratën, papa Thanasi.

P. THANASI

- (*Nuk i përgjegjet Bardhyllit e vazdhon mendimin:*) O "mosinò" (ndryshe), Lenë, ka i thuash fantazmëvet të traslokarjën (ndërrojën vend)!

LENA

- Të traslokarjën? Më duket lik: ormai (tashmë) jemi si...

P. THANASI

- Si gjiri?

LENA

- Ngë dej' thëshja "gjiri" ..., si...

P. THANASI

- Si gjitonë! "Punë e madhe ç'isht këjo!" - këndon poeti. (*I vendosur:*) I thua të traslokarjën! Yn' Zot na bekoftë. (*Del.*)

LENA

- Ëm uratën, zo'. (*Në qendër të dhomës, sikurse jui çel një dritë:*) Mah! Shohjëm... Kush e di...!

## SKENA IX

LENA, VINAU

VINAU

- (*Vjen nga puna.*) Si kle çë thërrite papa Thanasin!

LENA

- Kush t'e tha!



- VINAU - E pashë të dilëj (dilte).
- LENA - I tha një parkalesi tyt biri.
- VINAU - Të gjenj shërbëtyrë?
- LENA - Jo Bardhyllit!
- VINAU - E kujt?
- LENA - Sa bij ke?
- VINAU - Vërgolli ngë ka bsonjë (nevojë) parkalesi!
- LENA - I ka bsonjë: ti ngë e di çë ka bërë.
- VINAU - Ai mënd bënj atë çë do: ngë ë perikulus (i rrëzikshëm) si i madhi.
- LENA - Ti e ke me Bardhyllin!
- VINAU - U e kam me shërbëtyrën çë ngë ka! (*Ulet përpara tryezës.*)
- LENA - Çë i ftes (faj ka) ai!
- VINAU - Ëm të ha.
- LENA - Ngë kam përgatitur.
- VINAU - Ngë hahet?
- LENA - Ti ngë e di çë ka bërë yt bir.....
- VINAU - Jo, ngë e di, ma (por) di se ngë hahet!
- LENA - Yt bir...
- VINAU - Do t'i lësh këta diskurse e më thua përçë ngë ka ha?
- LENA - Ka të flas për tët bir....
- VINAU - Çilin?
- LENA - Vërgollin.
- VINAU - Pasgrëni më flet!
- LENA - (*Shkon te kuzhina e privet.*) Ë vetëm ca bukë e ca udhos (djathë). Ngë përgatita gjë. (*Shtron tryezën e vë edhe bukën e djathin.*)
- VINAU - Bukur të ngrënë! (*Kërkon të hajë.*)
- LENA - Kemi pasur lovrën (teatrin) me tët bir...
- VINAU - Flit (fol) e mos më lodh.
- LENA - Si ka e zë...?!
- VINAU - E m'ë pyen mua? Ti do flaç; për mua në më bëje ca të ngrënë ish më mirë...
- LENA - Zë nga të ngrënit...
- VINAU - Çë do thuash?!
- LENA - Ti e di se te tryeza ngaditë vë një tajur më shumë...
- VINAU - Devocjona!
- LENA - Devocjona! Ma ë një devocjonë speçiali (e veçantë)...



- (*Psherëtin e me zë të ulët:*) Te kjo shtëpi kemi njëtrë familje që rri me ne!
- VINAU - (*Duke vazhduar të hajë.*) E thërrite për tyj papa Thanasin?
- LENA - Ë ashtu si të thom! Ti ngë i sheh ma u i shoh.
- VINAU - (*Me ironi:*) Nani i sheh?!
- LENA - Vanë atej...
- VINAU - "Pi' la santa parola" (për fjalën e shenjte)! Je e lënë (e marrë)?
- LENA - Jo; ma në ka më preç (ndërpresësh) të folurit ngë flas më.
- VINAU - Ti sheh shumë televisionë!
- LENA - Çila televisionë? Çë sa ka çë u shua, ngë ë vjersh (mënyrë) të gjushtaret (ndreqet) më! Gjegjëm (dëgjomë), "mosinò" (ndryshe) qetem. (*Merr frymë.*) Janë katër vetë: Gjoni, i shoqi; Fina, e shoqja; Amelia, e bija; e vo' Thodha e jëma e Finës e nona e vajzës.
- VINAU - (*Ironik*) Ah, kanë vidhema (edhe) emret!
- LENA - Ata m'i thanë....
- VINAU - E ti përçë vë po një tajur te tryeza: o katrë o mosgjë! E pra hanë "shpirtrat"?! (*Bën gjestin të hajë, e pra ha vërtet.*)
- LENA - U vënë dakord ashtu e pra atyre i 'nteresar devocjona....
- VINAU - (*Serioz*) O mua isht e më bën ashtu (aciditet) këta udhos (djathë) o kam gjagjë te veshët!
- LENA - Përçë?
- VINAU - Për atë çë gjegjem! Ma (por) ti je i thua pë' ftet (vërtet) gjithë këto?
- LENA - Oraëj (po)! Janë katër...Vajza ë e bukur shumë, fine (shijehollë), delikate...
- VINAU - Më duket me vend se ë fine: ë fantazmë!
- LENA - (*Vazhdon me durim:*) Ma....
- VINAU - Çë kemi nani...
- LENA - Ajo isht e i nxier trutë prindravet se do...
- VINAU - Se do?
- LENA - Do martonet!
- VINAU - (*Bën thujse një kërcim.*) "Pi' la santissima parola" (për të stërshenjten fjalë)!
- LENA - Të bënë be se ë ashtu! Do martonet! Ata...
- VINAU - Ata, kush?
- LENA - Prindrat jerdh' e më folën mua.
- VINAU - Pë' mixanari (ndërmjetësi)?

- LENA - Jo. Të lypjën (lypnin)... Ajo do tët bir Bardhyllin! (*E thotë me shpejtësi e pret përgjegje.*)
- VINAU - (*Ngrëhet me një kërcim shtuara krejt i trazuar.*) “Pi’ la santissima parola”! Ti shërbiset ka m’i thuash dal’e dalë, se ka i marr supa (supë, thithje): ajo, vajza fantazmë, do tët bir, një-tër fantazmë?
- LENA - Mos tricijar (tallesh)! Shërbesi ë i rëndë.
- VINAU - (*Ulet*) E m’e thua mua se ë i rëndë?
- LENA - Do Bardhyllin!

#### SKENA X

ATA, GJONI, FINA, THODHA, AMELIA

(*Fantazmët hyjnë njëri pas tjetrit e grumbullohen në një kënd të dhomës.*)

- VINAU - Në ky ish një diskurs seriu (serioz), normal, të thëshja më parë se gjithqish: Bardhylli ë pa shërbëtyrë (punë) e ngë mënd ketë një familje, përçë vete sos se pra ka i jap të ngrënë u! Ma (por) ky ngë ë një diskurs seriu (serioz): ky ë një diskurs spicji (çmendine)! (*Merr frymë e me zë të ulët:*) Ti ka jesh e lënë!
- LENA - Ngë jam e lënë: u i shoh (*E vërtetë i sheh.*), i flas e duronj edhe llamentet (qarjet) e tyre!
- VINAU - Ah, përçë edhe llamindaren (qahen)?!
- LENA - Prindrat duan dinë çë thua ti! (*Fantazmët dëgjojnë të angosur.*)
- VINAU - “La santissima parola”! thom u!
- LENA - E çila ë? (*Vëren fantazmët.*)
- VINAU - Çë?
- LENA - (*E imiton*) “La santissima parola”!
- VINAU - Ajo ë një fjalac (fjalë e keqe)! U thom se lënësia (marrëzia) mënd jetë se merr edhe fantazmët!
- LENA - Qetu se të gjegjen!
- VINAU - Ah, përçë: janë këtu? (*Vëren përreth.*)
- LENA - Këtje janë! (*I tregon me lëvizje të kokës.*)
- VINAU - (*Ngrëhet e i kërkon.*) O krushq! (*Me ironi:*) Ngë ka i shtrëngo-jëm këta katrë eshtra? (*Zgjat dorën për të shtrënguar duart e tyre.*) Në ka jemi krushq ka njihemi e ka nderohemi njeri me tjetrin! (*Fantazmët shtrëngohen më shumë, megjithëse*

*Vinau nuk di ku janë.) Çë nderje! Çë gëzim! Do të më jipni dorën e vajzës tuaj për tim bir Bardhyllin? (Natyrisht flet me ajrin.)*

- AMELIA - O (po)! Këtu jam u! (*Largohet pak nga grupi, por Fina e mban afër.*)
- THODHA - Qetu e mos u tund! Se ai kush e di çë ka te kryet! Ngë më duket gjushtu (drejt)!
- LENA - Vina', nga, sose me këto pupacata (veprim kukullash)! "Sia fata" (u bëftë), vah!
- VINAU - (*Lenës*) Ah, përçë pupacatat i bënj u?! (*Ulet si më parë e bëhet serioz:*) Jo! Bardhyllin... (*Fantazmët e vërejnë me sy të hapur.*) Bardhyllin... ngë jue jap! Ë llanjus (përtac), ngë do shërbëtyrë; ma (por) ë një fugurë kopili: ngë jue jap!
- AMELIA - Oh, jo! (*I bie zali. Gjiria e saj e zgjon dhe e ndihmon të ecë gjer te dhoma e brëndshme.*)

#### SKENA XI

LENA, VINAU

- LENA - (*Vë duart në fytyrë e psherëtin.*) Me gjithë këto çë bëre ata vanë. Vajzës i ra zali...
- VINAU - (*Godas ballët*) Ah, përçë nani edhe fantazmëvet i bie zali! Zgjou! Përçë në ti je e nisur u kam kryet ankora (akoma) te vendi!
- LENA - Edhe u e kam te vendi!
- VINAU - Jo!
- LENA - E kam te vendi, përçë jam kuntent (e kënaqur) se i the jo. Ngë dua se im bir ka...
- VINAU - (*Me ironi*) Oh! E ke te vendi!
- LENA - Ma (por) vajza më duket keq...
- VINAU - Ata gjellën (jetën) e tyre e rruan...
- LENA - Amelia vdiq vajzë!
- VINAU - E u çë mënd i bënj: ç'i bëra u ligjiet e jetës?
- LENA - (*Fshin ndonjë lot.*) Më duket keq!
- VINAU - E çë do t'i bësh? I thua dy fjalë ngushllimi edhe nga ana ime!
- LENA - Mah! Ngë soset kurrë!
- VINAU - Çë ngë soset kurrë!
- LENA - Të sufriret! (vuajmë)



- VINAU - Ë gjithë një tricijatë (tallje)!
- LENA - Jo, ngë ë një tricijatë, përçë Vërgolli u namurar (mor me dashuri) Amelies... Ai e sheh!
- VINAU - (*Shumë i shqetësuar:*) Çë? E m'e thua nani?
- LENA - Ti i do thënë dal'e dalë njera prapa tjetrës!
- VINAU - Kjo bën të derdhet kudhi! Shohjëm: vajza do Bardhyllin, ma (por) Bardhylli ngë di se ajo e do: o e di? (*Lena ngrën kokën për të thënë: "jo".*) Nga ana e tij, Vërgolli do vajzën, e çila di se ai e do! E di? (*Lena ul kokën për të thënë: "po".*) E çë thotë vajza!
- LENA - Do Bardhyllin!
- VINAU - (*Serioz:*) I japjëm Vërgollin!
- LENA - Çë të dollën trutë?
- VINAU - Ah, mua më dollën trutë! (*Ironik:*) Djalin ka e kunditarjëm (kënaqim)! E pra çila vajzë mënd detë një djalë i kopjasëm? (*Merr frymë.*) Këtu ë spicji (çmendina)! E jot bijë Ursulla do njeri?
- LENA - (*Me çudi*) Eh? Ngë do njeri!
- VINAU - Ngëse ka ndonjë vëlla, kjo Amelie!? Ia japjëm sat bije e ashtu lidhemi me dy tërkuza! (*Papritur ngrëhet e bën si një filim valleje, ndërta këndon me rimë:*) Bëjëm festë e hare / e lënësia rri bashkë me ne!

### AKTI III

#### SKENA I

#### VËRGOLLI, AMELIA

- VËRGOLLI - (*I frymëzuar*) Përçë hyn te ëndrrat time (e mia)?
- AMELIA - (*E përqëndruar te ëndrrat e saj, lëviz ngadalë për gjithë dhomën.*) U ngë hynj te ëndrrat tote (e tua)!
- VËRGOLLI - Sonte natën ishe me mua: ti! (*E tregon me gisht.*)
- AMELIA - U? Ngë mënd jetë kurrë!
- VËRGOLLI - Ishëm bashkë e... u kishëm martuar!
- AMELIA - Martuar? (*Vëren sendet e dhomës.*)
- VËRGOLLI - Sat'ëmje i bijën lotë si grushte me gëzimin!
- AMELIA - U ngë kam ardhur kurrë te ëndrrat tote (e tua)!
- VËRGOLLI - E di te çilat ëndrrat ti kërkon të hysh! Ma (por) giejjëm



(dëgjomë) përçë të flas me ndjenjat, me sentimentet, e ëndrrës që bëra sonte natën.

- AMELIA - U kërkonj...
- VËRGOLLI - (*Me zë të sigurt:*) U e di kë kërkon ti, ma gjegjëm ca herë... (*I frymëzuar e i lumtur:*) U kishëm martuar, po shërbesi çë ngë mënd harronj ish ndjenja e pasurisë, çë kisha - më ndël-gon? Ti ishe imja e u ndihesha njeriu m'i qosmë (i pasur) i gji-thësisë: kisha tyj! Ndhiesha mirë, i fortë, me shëndet! Ë kjo lumëria!
- AMELIA - Ish një ëndërr...
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) E ti çë je? Ngë je ëndërr?
- AMELIA - Ngë jam ëndërr; ngë dua...
- VËRGOLLI - Ngë do...?
- AMELIA - Ngë dua të më ëndërrish ti!
- VËRGOLLI - Je e ligë, pa shpirt! Ti ngë mënd urdhurosh te ëndrrat time! Ti më vret me këto fjalë...
- AMELIA - Nga njeri vete prapa ëndrravet të tij... (*Bën për të dalë.*)
- VËRGOLLI - Mos veç: lemë të sos. (*Amelia pret, por nuk e vëren.*) U... u dishiroja ti të ishe fjalë e u të të pëshpërisja përgjithmonë!
- AMELIA - Ke shpirt poeti!
- VËRGOLLI - U dishiroja ti të ishe mendim e u të të mbaja në tru përgjithmonë!
- AMELIA - (*Pa vërejtur Vërgollin:*) U e di se ti më do, ma (por) ti ngë ke bsonjë kah u: ti ke bsonjë (nevojë) një grua-mëmë...
- VËRGOLLI - Mëmën e kam!
- AMELIA - Një grua mëmë çë ngë ë jot'emë. U ngë kam ndjenja mëmje!
- VËRGOLLI - U ngë të shoh si mëmë e ngë dua një grua-mëmë: dua tyj!
- AMELIA - Ti je i sëmur e shihet: u çë jam "kështu" ngë mënd të dua: u dua një njeri çë ë shëndeta!
- VËRGOLLI - Ti ngë mënd duash gjë!
- AMELIA - Përçë ngë mënd dua gjë? (*Këtë herë e vëren.*)
- VËRGOLLI - Ti je fantazmë! (*Me zë të lartë:*) Ti ngë sistir (eksiston)!
- AMELIA - E përçë më do në ngë sistir? (*Nuk e vëren më.*)
- VËRGOLLI - Për "mua" sistir, vetëm për "mua"! Bardhylli ngë të ka parë kurrë!
- AMELIA - Ma (por) u e shoh! (*E lumtur:*) U e shoh e kur e kam përpara ndihem e gjallë!
- VËRGOLLI - Jemi paraç: lënësi imja e lënësi jotja!

SKENA II  
ATA, BARDHYLLI

- BARDHYLLI - (*Hyn nga jashtë.*) Flet vetëm? (*Amelia ndizet nga gëzimi.*)  
VËRGOLLI - Ngë flas vetëm...  
BARDHYLLI - E me kë andaj?!  
VËRGOLLI - Ngë t'e thom.  
BARDHYLLI - Andaj flet vetëm!  
VËRGOLLI - (*Me zë të lartë*) Ngë flas vetëm!  
BARDHYLLI - E mos lurij...  
VËRGOLLI - T'e thom!  
BARDHYLLI - (*Me ironi*) Thuajme!  
VËRGOLLI - Flas me një vajzë... (*Amelia vëren Bardhyllin me sy dashurie.*)  
BARDHYLLI - Një vajzë? Ngë shoh vajza këtu! Ku ë? (*Amelia tregon veten e pranishme.*)  
VËRGOLLI - Ti ngë e sheh!  
BARDHYLLI - (*Me ironi*) E ti e sheh?  
VËRGOLLI - U e shoh!  
BARDHYLLI - E si ë?  
VËRGOLLI - E bukur shumë...  
AMELIA - Oh, Vërgo': je i mirë!  
VËRGOLLI - (*Me zë të lartë*) Ngë jam i mirë!  
BARDHYLLI - Ngë je i mirë? E di, ma përçë e thua?!  
VËRGOLLI - Flisja me "atë" e jo me tyj!  
BARDHYLLI - Thuajmë kur flet me "atë" e kur flet me mua!  
VËRGOLLI - Dua se ka të njohënj... tyj!  
BARDHYLLI - Mua?  
VËRGOLLI - Tyj!  
BARDHYLLI - E atëherë le t'e bëjëm këtë njohje: "ajo" si ë?  
VËRGOLLI - T'e tashë: e bukur shumë! (*Amelia merr dritë.*)  
BARDHYLLI - Si i thonë?  
VËRGOLLI - Amelia!  
BARDHYLLI - Ah, Amelia! Për këtë, kur lurije, thëshje "Amelia"! È vajza jote?  
VËRGOLLI - (*Ul kokën.*) Jo ngë ë vajza ime: ngë më do! (*Pret e vëren nën sy të vëllain.*) Do tyj!  
AMELIA - Oh, zëmra si më kërcen! (*Mban gjirin.*)  
BARDHYLLI - Do mua? (*Ulet përballë të vëllait duke treguar interesim.*)

- VËRGOLLI - Ëj (po), do tyj!
- AMELIA - Më mirren sytë! (*Vë të drejtën përpara syve.*)
- BARDHYLLI - E ku ë? (*Thotë ndërsa vëren përçark.*)
- VËRGOLLI - (*Pa e treguar.*) Këtje ndanëz (afër) derës.
- AMELIA - Këtu jam!
- VËRGOLLI - (*Amelies:*) Ngë të gjegjet!
- BARDHYLLI - Ngë më gjegjet?
- VËRGOLLI - Me "atë" flisja...
- BARDHYLLI - E çë tha!
- VËRGOLLI - Se ë aty!
- BARDHYLLI - (*Vanitoz, përkrash lodrën e flet drejt vendit ku mendon se ndodhet Amelia:*) Oh, dua të të njoh, Amelia! Dua të të ngas!
- VËRGOLLI - E thëshja u: ti vete njize (shpejt) te duart! "Të të ngas"! Dora ë "il veicolo" (mjete mbartës) i dashurisë! Si bën të mos ngaç? Adhami kur pa Evën më parë e vërejti, ma (por) të shihëj në mos ish bërë gumje vate e ngau (preku)! (*Bardhyllit:*) E ti ngite!
- BARDHYLLI - (*Ngrëhet*) Ku je?
- AMELIA - Qasem u tek ti! (*Vjen nga njëra anë, ndërsa Bardhylli vete nga ana tjetër.*)
- BARDHYLLI - (*Vë n'urdhër flokët:*) Ku je?!
- VËRGOLLI - (*Drejton skenën.*) Ajo ë këtje e ti je këtu!
- BARDHYLLI - (*Amelies:*) Nani çë di se më do mua edhe u dua tyj! Ma ku je?!
- AMELIA - Oh, m'e tha, m'e tha se më do! I ëmbël, i dashur... (*Ecën si nëndërr, ndërsa kërkon të afrohet te Bardhylli.*)
- VËRGOLLI - Duhij të dy! (*Me zë të lartë:*) Festë e madhe! Gëzim i madh!
- BARDHYLLI - (*Vazhdon të ecë ngadalë në anë të kundërt të Amelies.*) U jam këtu e ti ku je? (*Qëndron.*)
- AMELIA - I dashuri, i ëmbli, i miri...
- BARDHYLLI - (*Vërgollit*) Ma ku ë?!
- VËRGOLLI - Ngë të sheh!
- AMELIA - Ngë më sheh?
- VËRGOLLI - Ngë të sheh!
- BARDHYLLI - Ngë më sheh?
- VËRGOLLI - Ngë flas me tyj o më mirë flas me të dy: duhij ma ngë shihij: "amore a non prima vista"!
- BARDHYLLI - Je më tricijar (tallesh), ëh?



- VËRGOLLI - Jo. Vajza ë aty, aqë e bukur se ti kaq të bukura ngë ke parë kurrë!
- BARDHYLLI - Tricijar (talles)! (*Ulet në karrige.*)
- VËRGOLLI - Jo, ngë tricijar. T'ë thashë: ti ngë e sheh e ngë kam çë të të bënj!
- AMELIA - (*Bardhyllit*) Oh, përçë më lë!
- VËRGOLLI - (*Amelies*) Ngë të sheh!
- AMELIA - I qasem u atij! (*E bën.*)
- VËRGOLLI - Bardhyll, aty te ana e ke!
- BARDHYLLI - (*Bën gjestin me dorë.*) Këtu?
- VËRGOLLI - Ëj, (po), aty aty: ngite, përqafoje! (*Me të vërtetë Amelia nuk është aq afër.*)
- BARDHYLLI - (*Ngrëhet më këmbë e përqaфон ajrin.*) Kështu?

SKENA III  
ATA, URSULLA

- URSULLA - (*Vjen nga jashtë e sheh Bardhyllin që përqaфон ajrin.*) Bardhyll, çë bën ashtu?
- VËRGOLLI - (*Duke qeshur:*) Përqaфон një vajzë e bukur çë ngë sheh!
- URSULLA - (*Bardhyllit*) Nani në i jep kordë edhe ti!
- BARDHYLLI - (*Ulet me shpejtësi.*) Luaja!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë*) Jo, ngë luaje! Ngë luaje! Të shkëlqejën sytë! Të dridhej zëri!
- AMELIA - Të shkëlqejën sytë, të dridhej zëri! Ngë luaje, jo ngë luaje! (*Vete prapa prapa ngadalë.*)
- BARDHYLLI - Luaja! (*Ndërron të folur; Ursullës:*) E ti përçë vjen brënda më këtë herë?
- URSULLA - Sot kishëm gjymisë ditje te shërbëtyra e jerdha te shpia (shtëpia)! (*Vërgollit:*) Çë ish e bëj Bardhylli?
- VËRGOLLI - Nani t'ë thom...
- BARDHYLLI - (*Ngrëhet për të dalë jashtë.*) U vete...
- AMELIA - Jo, mos veç... U ngë luaja e ti ngë luaje..., u e di!
- VËRGOLLI - Jic! Jicni të dy!
- URSULLA - (*Vërgollit, duke kuptuar ndryshe:*) U hyra nani nani e ngë kam dishirim të dalënj pameta!
- VËRGOLLI - Ngë t'ë thëshja tyj...
- BARDHYLLI - M'ë thëshëj mua e... asaj! (*Tregon me dorë ajrin.*)
- URSULLA - Asaj, kujt? U ngë shoh njeri! (*Vëren përqaфон.*)
- VËRGOLLI - (*Ursullës*) Në t'uje (ulesh) t'ë thom.
- BARDHYLLI - (*Vërgollit*) Sose ca herë! (*Del me vrull.*)



AMELIA - (*Me lotë ndë sy:*) Ngë luaje! Ngë luaje! (*Shkon te dhoma e brëndshme.*)

#### SKENA IV

ATA, FINA, GJONI, THODHA, AMELIA

- VËRGOLLI - (*Ursulla ulet.*) Flisja me Amelien!  
URSULLA - E kush ë kjo Amelie?! U ngë shoh njeri... (*Vëren përqark.*)  
VËRGOLLI - Ngë shihet.  
URSULLA - Në ngë shihet ti si e sheh?  
VËRGOLLI - U e shoh.  
URSULLA - (*Me ironi*) Vetëm ti!  
VËRGOLLI - U e... mëma...  
URSULLA - Ah, mëma! Ngë më ka thënë kur gjë.  
VËRGOLLI - Këto janë shërbise çë ngë thuhën.  
URSULLA - Ti je i thua.  
VËRGOLLI - Nani ëj (po), përçë vjen dita çë ka flitet: u shoh Amelien...  
URSULLA - E Bardhylli e sheh?  
VËRGOLLI - Jo, ai sheh shërbise çë ngiten (preken)... (*Me zë poetik:*)  
"U" e shoh: ë aqë e bukur se kur e vëren qëndron ashtu... pa fjalë e brënda - këtu brënda (*Prek gjoksin*) - ndien një të dhëmbur të ëmbël, të dishpëruar, përçë dishpërimi ë të ndierit çë ajo të jep më shumë: dishpërimi se ngë mënd e kësh gjithë për tyj... e u për mua ngë mënd e kem, se...  
URSULLA - Se?  
VËRGOLLI - Se ngë më do.  
URSULLA - Ngë të do?  
VËRGOLLI - (*Ul kokën*) Do Bardhyllin.  
FINA - (*Hyn nga dera e brëndshme.*) Vërgo', ku vate ime bijë?  
VËRGOLLI - Ngë e di!  
URSULLA - (*Konsekuente*) E di o ngë e di?!  
FINA - E ku vate! (*Del.*)  
VËRGOLLI - (*Ursullës*) Çë ngë di?  
URSULLA - Ti the se do Bardhyllin: u të pyejta "Do Bardhyllin?" e ti m'u përgjegje se ngë e di!  
VËRGOLLI - Jo, ngë flisja me tyj...  
URSULLA - E me kë?! (*Vëren përqark.*)  
VËRGOLLI - Hyri e jëma e më pyejti ku ë e bija...  
URSULLA - Ah, hyri e jëma? E ku ë nani?  
VËRGOLLI - Vate...

- URSULLA - Vate!?! Mah! (*Me dorë kreh flokët si për të larguar mendimet:*)  
Si bënj u të kem gjithë këtë paçencë (durim)! (*Merr frymë:*)  
Thëshje se do Bardhyllin...
- VËRGOLLI - “Ajo” isht e del e lënë o më mirë dolli...
- URSULLA - E Bardhylli?
- VËRGOLLI - Ish e del i lënë se ngë arrën t’ë shohënj! I thashë se ë e bukur shumë...
- GJONI - (*Hyn*) Vërgo’, ke parë time bijë?
- VËRGOLLI - E pashë njëment, nani ngë e di ku ë! (*Gjoni del.*)
- URSULLA - Çë?
- VËRGOLLI - Ngë flisja me tyj...
- URSULLA - Hyri i jati?
- VËRGOLLI - E ti si e di?! Çë e pe?
- URSULLA - Jo, ngë e pashë; ma (por) në hyri e jëma kish hyj nani edhe i jati!
- THODHA - (*Hyn*) Vërgo’, kërkonj vajzën, ku ë?
- VËRGOLLI - (*Me nervozizëm*) Ngë e di!!! Ngë jam sekretari i saj u!
- THODHA - Ngaherë i t’ëmbël ti! (*Del*)
- URSULLA - Ish noni (gjyshi)!
- VËRGOLLI - Jo, nona (gjyshja). Përcë?
- URSULLA - (*Me ironi*) Jo, ashtu...
- VËRGOLLI - (*Ndien ironinë.*) Ti e ke me mua! Ti ngë më ke besë! Lemë në paqe me ëndrrat time, me fantazmët tim (e mi)...
- URSULLA - (*Serioze*) Vërgo’, gjegjem. Ngë kam folur kurrë kështu rëndë (seriozisht). Gjegjem. Lei këta fantazmë, mos bëj këto ëndrra: përcë të qelljën (sjellin) llargu nga jeta reale, nga kjo jetë! Ti je i kopjasëm, ma ngë vje’më thënë se trutë ngë i ke të mira. Gjithë, pak o shumë, jemi të kopjasëm! Përcë “l’handicappato” ngë ë vetëm ai çë ngë mënd tundet si do, ë edhe fatziu, ai çë ngë mënd zgjidhet nga bsonja (nevoja), ai çë leu i vapkë (varfër) e ngë arrën të dalënj (dalë) nga kondicjona e tij; janë mijëra e mijëra! Sot i kopjasm i te kurmi, si ti, ë mbajtur më mirë se ca vjet prapa; nani, si ke parë në televisionë, bëjnë “gare sportive” për kopijtë si ti. “Le olimpiadi” kanë bërë! Më gjegje? (*I qaset me shexhën-karrigen të vëllait.*)
- VËRGOLLI - Të gjegjem, ma ti Amelien ngë e ke parë!
- URSULLA - E ngë dua t’ë shoh! Amelia ë një fantazi jote, ëndrra jote të kesh një vajzë: Amelia ngë sistir (eksiston)!
- VËRGOLLI - (*Me zë të lartë:*) Jo, sistir (eksiston)!

- URSULLA - Ë fantazi jote! Hap sytë e ligjëro (arsyeto) me trutë! Zgjou! Zgjou ti e sheh se edhe mëma zgjonet... Zgjonemi të gjithë! (*Fantazmët, njëri prapa tjetrit, hyjnë.*)
- VËRGOLLI - (*Me zë të ulët:*) Janë gjithë aty!
- URSULLA - Kush?! (*Vëren përçark.*)
- VËRGOLLI - Amelia, i jati, e jëma, nona!
- URSULLA - (*Me ironi*) Ngë lypset njeri?
- VËRGOLLI - Ti the se ngë sistirjën (eksistojnë) e nani ata janë të trëmbur! (*Fantazmët grumbullohen në një kënd.*)
- URSULLA - U thom se i trëmbur je ti se të thashë se ngë sistirjën. Shko dorën (*Bën gjestin*) te sytë e si e ke shkuar sheh se spirirjën (zhduken)!
- VËRGOLLI - (*Bën gjestin.*) Ngë spiritën: janë aty!
- URSULLA - Je ti çë ngë do të spirirjën!
- VËRGOLLI - Ngë dua.
- URSULLA - E përçë?
- VËRGOLLI - Përçë qëndronj vetëm! Ti flet bukur, ma ti vete shërben, Bardhylli ë burrë qacje (sheshi), tata ë ngaditë jashtë; me mua rri mëma e... (*Tregon Fantazmët.*)
- URSULLA - Ke liq (të drejtë)! Ma (por) në ti ngë zgjone, na ngë mënd të ndihjem.
- VËRGOLLI - Ka zgjonem?
- URSULLA - (*Ngrëhet*) Oraëj (po)!
- VËRGOLLI - Ma ëndrra ë e bukur!
- URSULLA - E ti thua e bukur një ëndërr ku vajza jote ngë të do?
- VËRGOLLI - (*Ndërsa vëren Fantazmët në angh.*) E dishirimi të e kem, të e dua edhe se ngë më do, ngë ka vlerje?
- URSULLA - Ti do një fantazmë: ti do mosgjë! (*Fantazmët fillojnë të dalin.*)
- VËRGOLLI - Jo! Mos veni! (*Ata qëndrojnë.*)
- URSULLA - Me kë flet!?
- VËRGOLLI - Me ata: ish e vejën...
- URSULLA - (*Me autoritet*) Le të venë!
- VËRGOLLI - Jo, dua t'e prisgodhir (bind) më parë...
- URSULLA - Kë?!
- VËRGOLLI - Amelien! (*Fantazmët dalin nga dera e brëndshme.*)
- URSULLA - Basta (mjaft)! U lënësonem me ty!
- VËRGOLLI - E sheh se e zbier paçencën (durimin)?
- URSULLA - E zbier se ti flet për shërbise çë ngë janë; flit (fol) për shër-



bise që janë, që shihen, që ngiten e u paçencën (durimin) ngë e zbier!

VËRGOLLI - Edhe ti je për shërbiset që “ngiten”..., si i do Bardhylli!

### SKENA V

ATA, BARDHYLLI, GAUDENCJA, AMELIA

- BARDHYLLI - (*Hyn*) Kush flet për mua? Vërgolli! (*Tregon derën e jashtme, nga do të hyjë Gaudencja.*) Pa vëreni kë kam këtu! (*Gaudencjës:*) Entra, entra!
- GAUDENCJA - (*Veshur në mënyrë që bie në sy, hyn me efekt-bujë.*) Buon giorno, cari!
- VËRGOLLI - (*Me çudi*) E kjo kush ë?!
- URSULLA - Bardhyll, që janë këto novë!
- BARDHYLLI - (*Me krenari*) Vajza ime!
- URSULLA - Ka (nga)... jerdhi!
- BARDHYLLI - Jerdhi me postën (autobusin) nga Palerma... Ë nusja ime!
- URSULLA - E kur u bëre dhëndër!
- BARDHYLLI - E njoha Palermë. Si të duket? (*E tregon.*)
- URSULLA - Se “duket”, “duket” e makari (makar) shumë!
- VËRGOLLI - Γυῶθι σαυτόν! - Njih veten tënde e të thom që merr!
- GAUDENCJA - Ma come parla?
- BARDHYLLI - È mio fratello, quello... (*Nënkupton se ajo e di.*)
- VËRGOLLI - “Handicappato”!!!
- GAUDENCJA - Piacere!
- VËRGOLLI - Se jam i kopjasëm? Kjo flet hapët!
- BARDHYLLI - (*Paraqit Ursullën:*) Mia sorella.
- GAUDENCJA - (*Qaset e e puth.*) Piacere!
- URSULLA - (*E çuditur, me vete:*) Njize zuri kjo të puthëj! Si i thonë?
- VËRGOLLI - Ngë r’ e ka thënë: Pjaçere!
- BARDHYLLI - Pjaçere?
- VËRGOLLI - Thotë emrin o thotë atë që di të japënj?
- BARDHYLLI - Mos flit (fol) difiçili (vështirë)! Ngë i thonë Pjaçere; thërritet Gaudencja!
- GAUDENCIA - (*Kupton se Bardhylli ia prezanton Vërgollit:*) Piacere!
- VËRGOLLI - E gjegje? Gaudencja Pjaçere! (*Mban gazin.*)
- URSULLA - (*Bardhyllit*) E mëmës që ka i thuash?
- BARDHYLLI - Se vura kryet te vendi...
- VËRGOLLI - (*Qesh me ironi.*) Ah, ah, ah: vuri kryet te vendi!
- GAUDENCJA - (*Duke treguar Vërgollin:*) Ride?



- BARDHYLLI - Te l'ho detto che è spiritoso!
- VËRGOLLI - (*I mendueshëm*) E nga se vjen fjala "spiritus", përçë "këtë" (Gaudencjën) e prure te shpia (shtëpia)? Në e sheh "shpirti" i Amelies?
- BARDHYLLI - Xhullusjaret (ndien xhelozit)? Le t'ë shohënj!
